RAPORTI VJETOR I PUNËS SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE....5

PJESA 1....6

1.1. HYRJE....6
1.2. HISTORIA E AZGJ-së....7
1.3. MISIONI DHE VIZIONI....8

PJESA 2....9

2.1. STATUSI....9
2.2. UDHËHEQJA....9
2.3. KOMPETENCAT LIGJORE TË AZGJ-së....9
2.4. PARIMET DHE VLERAT E PUNËS....10

PJESA 3....11

3.1. VENDOSJA ORGANIZATIVE....11
3.2. BURIMET NJERËZORE....14
3.3. STRUKTURA E TË PUNËSUARVE....16

PJESA 4....19

4.1. PASQYRA E PUNËS....19
4.2. KËRKESAT E PRANUARA PËR PËRKTHIM DHE LEKTURIM....20
4.3. PYETËSORËT ANKETUES DREJTUAR INSTITUCIONEVE TË SEKTORIT PUBLIK....21
4.4. PYETËSORI ONLLAJN PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE ZYRTARE NË

GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME....26
4.5. REGJISTRI I PËRKTHYESVE DHE I LEKTORËVE NË SEKTORIN PUBLIK....28
4.6. TRAJNIMI PËR PËRDORIMIN E SOFTUERIT TË PËRKTHIMIT – TRADOS..28
4.7. PARASHTRESAT E PRANUARA....29
4.8. INFORMIMI....30
4.9. BULETINI MUJOR....30
4.10. UEB FAQJA ZYRTARE DHE MEDIET DIGJITALE....31
4.11. BOTIMET E SHTYPURA DHE ATO ELEKTRONIKE TË AZGJ-së NË VITIN 2020....33
4.12. PASQYRA E AKTEVE TË SHPALLURA NË "GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT" NË VITIN 2020....36

PJESA 5....40

5.1. PASQYRA E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA....40

PJESA 6....132

6.1. BUXHETI, LLOGARIA PËRMBYLLËSE DHE FINANCIMI....132
6.2. FURNIZIMET PUBLIKE....134

REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE....135

FJALA HYRËSE



Para jush është Raporti i dytë vjetor i punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AZGJ) gjatë vitit 2020, që paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve dhe përpjekjeve të AZGJ-së në përmirësimin e mbrojtjes dhe avancimin e të drejtave gjuhësore, përforcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe përkrahje për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të mundësuar realizimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve.

Edhe krahas punës në kushte të pandemisë globale shëndetësore, të shkaktuar nga virusi korona SARS CoV-2 (Covid-19) dhe kufizimeve të lidhura me realizimin e takimeve të drejtpërdrejta, ngjarjeve dhe anulimit të takimeve të dakorduara në vend dhe jashtë tij, përsëri AZGJ-ja edhe në vitin 2020 realizoi një sërë aktivitetesh në aspektin e kryerjes së kompetencave të veta ligjore. Republika e Maqedonisë së Veriut edhe pse ka legjislaturë të avancuar, me të cilën rregullohet përdorimi i gjuhëve në sektorin publik, gjatë zbatimit të saj praktik, prapëseprapë, shfaqen vështirësi dhe sfida, që tregon se ka nevojë të përpiqemi akoma më tepër deri në arritjen e qëllimeve të caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, e ato janë promovimi, mbrojtja dhe zbatimi i njësuar i gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe).

Në vazhdim mund ta lexoni raportin, të cilin e japim si pasqyrë të hollësishme për të gjitha aktivitetet e ndërmarra. AZGJ-ja me kapacitet të plotë dhe me fokusim akoma më të lartë, do të vazhdojë me punë edhe në periudhën në vazhdim, për arsye se angazhimi ynë është që të realizohen të drejtat gjuhësore të qytetarëve dhe besojmë se me ndihmën e tyre do ta arrijmë qëllimin e përbashkët drejt ndërtimit të shoqërisë së qytetarëve të barabartë.

Me respekt,

prof. dr. Ylber Sela,

drejtor

PJESA 1

1.1. Hyrje

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut [1] (në tekstin e mëtutjeshëm: AZGJ) është themeluar në përputhje me ligjin, në cilësinë e personit juridik, e që është kompetente për standardizimin dhe njësimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Raporti Vjetor i Punës ka të bëjë me periudhën 1.1.2020 deri më 31.12.2020 dhe është përgatitur në bazë të nenit 18, paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 7/2019), sipas të cilit AZGJ-ja për punën e saj dorëzon raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së paku një herë në vit, deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Raporti përmban rishikimin e aktiviteteve të AZGJ-së në zbatimin e kompetencave të saj ligjore, me qëllim që të realizohen të drejtat gjuhësore të gjuhëve zyrtare, zbatimi i vazhdueshëm i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimi i kapaciteteve përkthyese të institucioneve etj. AZGJ-ja në punën e saj ishte e vendosur në qëllimin aktiv, që të veprojë në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet promovimit të të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër të gjitha përpjekjeve, raportet tona nga terreni, parashtresat e qytetarëve, raportet e medieve dhe të organizatave joqeveritare, tregojnë se shumë qytetarë akoma përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj në komunikimin e përditshëm me institucionet. Kjo tregon se ka nevojë që të gjitha institucionet të japin shumë mund për t’i arritur qëllimet e caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Të udhëhequr nga qëllimi për t’u zgjidhur problemet institucionale lidhur me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në institucione dhe cilësinë e dobët të

[1] Forma e shkurtër e emrit zyrtar: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

përkthimeve dhe lekturimeve nëpër dokumentet zyrtare, AZGJ-ja ndërmori aktivitete për përforcimin e kapaciteteve të veta për përkthim, duke u furnizuar me softuerin e përkthimit nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas, me të cilin do të lehtësohet dhe do të zvogëlohet dukshëm koha e nevojshme për përkthimin e dokumentacionit zyrtar.

1.2. Historia e AZGJ-së

Më 6 shkurt 2019 u shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të AZGJ-së, që zgjati në përputhje me datën 13 shkurt 2019, ku me Aktvendimin e zgjedhjes, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen mbajtur më 25 shkurt 2019, u zgjodh prof. dr. Ylber Sela si drejtor i AZGJ-së.

Më 11 mars 2019 u dorëzua fletëparaqitje për regjistrimin e themelimit të AZGJ-së në Regjistrin Qendror, ku aktvendimi për regjistrimin e themelimit u miratua më 13 mars 2019. Data formale e themelimit të AZGJ-së është 14 janar 2019, respektivisht dita e hyrjes në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.7/2019). Nga themelimi i saj, selia formale e AZGJ-së ishte në bul. "Ilindeni" nr.2/ ndërtesa 6 – zyra 410.

Në mbledhjen e 162-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 5 nëntor 2019, Qeveria e miratoi Vendimin nr. 45-8714/1, për dhënie në shfrytëzim të përhershëm të sendeve të patundshme të AZGJ-së ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 236/2019), që ishte bazë për t'u kryer regjistrimi për ndryshimin e selisë së AZGJ-së, ku me Aktvendim të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120190016864 të datës 21.11.2019, u bë ndryshim i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresë të re: shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr.4, kati 4, Qendër, Shkup, gjithashtu është regjistruar edhe shkurtesa e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është bërë "Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV".

1.3. Misioni dhe vizioni

AZGJ-ja ka mision të ndërtojë mjedis institucional që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, që e promovon, që e ruan dhe që e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo përfshin aktivitete lidhur me ndihmesën praktike dhe përkrahjen këshillëdhënëse në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, agjencive, drejtorive, institucioneve dhe organizatave, komisioneve, personave juridikë që kryejnë autorizime publike, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale; kujdes i vazhdueshëm për zbatim të rregullt dhe të qëndrueshëm të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe), si dhe avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës, si e drejtë themelore e qytetarëve.

Vizioni i AZGJ-së është të mundësojë barazi gjuhësore të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të rregullores ligjore për përdorimin e gjuhëve. Duke nxitur cilësi të lartë të proceseve të punës, efektivitet të vazhdueshëm dhe efikasitet në punë, të plotësuar me kuadër profesional dhe kapacitete teknike, si dhe të hapur plotësisht për bashkëpunim me publikun, sektorin akademik dhe atë qytetar, AZGJ-ja synon të bëhet e njohur si institucion me rëndësi strategjike në procesin e mbrojtjes, avancimit, standardizimit dhe përdorimin e njësuar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA 2

2.1. Statusi

AZGJ-ja ka cilësinë e personit juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Më 14.1.2019 në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2019 u shpall dhe hyri në fuqi Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, me çka AZGJ-ja u themelua në cilësinë e personit juridik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të caktuara me të njëjtin ligj.

2.2. Udhëheqja

AZGJ-në e udhëheq drejtori i zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar, me të drejtë për t'u rizgjedhur. Për punën e tij dhe për punën e AZGJ-së, drejtori i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.3. Kompetencat ligjore të AZGJ-së

Në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, AZGJ-ja është kompetente për kryerjen e punëve në vijim:

- mbështetjen e institucioneve për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturimin e të gjithë akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut";
- promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- përgatitjen e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zbatimin e kompetencave të saj;

- përgatitjen e materialeve profesionale-analitike nga kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe
- punë të tjera që lidhen me zbatimin e qëllimeve të vërtetuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Krahas kompetencave të saj ligjore, AZGJ-ja kujdeset për sigurimin e vazhdueshëm të funksionalitetit dhe forcimin e kapaciteteve të veta, si dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, e promovon, e ruan dhe e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.4. Parimet dhe vlerat e punës

- ligjshmëria;
- profesionalizmi dhe kompetenca;
- përfaqësimi i duhur dhe i drejtë;
- shërbimet e orientuara;
- etika profesionale, paanshmëria dhe objektiviteti;
- transparenca dhe besueshmëria;
- përgjegjësia;
- parandalimi i konflikteve të interesit;
- të qenit ekonomik; dhe
- respektimi i standardeve për udhëheqje me cilësi.

PJESA 3

3.1. Vendosja organizative

Duke u nisur nga kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Nëpunësve Administrativë, si dhe nga Dekreti për Parimet e Organizimit të Brendshëm të Organeve të Administratës Shtetërore, e me qëllim të bashkimit të disa funksioneve të ndërlidhura ndërmjet tyre, organizimin, ndjekjen dhe koordinimin me burimet njerëzore, punën profesionalo-analitike, administrative, informativo-komunikuese, operative, materiale, financiare, informatiko-teknologjike, profesionalo-administrative dhe punë të tjera, në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, AZGJ-ja është e organizuar në 4 (katër) sektorë me 9 (nëntë) njësi në përbërje të tyre dhe 2 (dy) njësi të pavarura, siç vijon:

(1) Sektori i mbështetjes së drejtorit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Njësia e mbështetjes së drejtorit; dhe
- Njësia e marrëdhënieve me publikun.

(2) Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e avancimit të zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve;
- Njësia e teknologjisë informatike; dhe

(3) Sektori i përkthimit dhe i lekturës, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e përkthimit; dhe

- Njësia e lekturës.

(4) Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e punëve të përgjithshme dhe juridike; dhe

- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësitë e pavarura janë:

(1) Njësia e çështjeve financiare; dhe

(2) Njësia e revizionit të brendshëm.

DREJTORI

KËSHILLTAR SHTETËROR I PËRKTHIMIT

KËSHILLTAR SHTETËROR I LEKTURËS

KËSHILLTAR SHTETËROR I BASHKËPUNIMIT ME QEVERINË DHE PUBLIKUN

NJËSIA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM

NJËSIA E ÇËSHTJEVE FINANCIARE

Organigrami i AZGJ-së

SEKTORI I MBËSHTETJES SË DREJTORIT

- NJËSIA E BASHKËPUNIMIT ME QEVERINË E RMV-së
- NJËSIA E MBËSHTETJES SË DREJTORIT
- NJËSIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, I KOORDINIMIT DHE I ZHVILLIMIT

- NJËSIA E AVANCIMIT DHE E ZBATIMIT TË GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE
- NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIKE

SEKTORI I PËRKTHIMIT DHE I LEKTURËS

- NJËSIA E PËRKTHIMIT
- NJËSIA E LEKTURËS

SEKTORI I PUNËVE TË PËRGJITHSHME, JURIDIKE DHE I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- NJËSIA E PUNËVE TË PËRGJITHSHME DHE JURIDIKE
- NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

3.2. Burimet njerëzore

Në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, janë paraparë 74 vende të punës. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të parapara të punës, 71 vende janë me statusin e nëpunësit administrativ, kurse tri vende janë me statusin e personave ndihmës-teknikë.

Në AZGJ me gjendjen e datës 31.12.2020 janë punësuar gjithsej 18 persona, që kanë statusin e nëpunësve administrativë, prej të cilëve një personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës për shkak të emërimit në funksion tjetër publik, ndërkaq në mënyrë plotësuese edhe një person tjetër me procedurë lëvizshmërie është transferuar nga një organ tjetër. Gjatë vitit 2020 në AZGJ nuk janë hapur shpallje publike për punësim të nëpunësve administrativë.

Në pajtim me datën 31.12.2020, përqindja e plotësimit të vendeve të punës sipas realizuesve, arrin 24,32% nga numri i përgjithshëm i sistematizimit sipas realizuesve.

Plotësimi i vendeve të punës në AZGJ i shprehur në numra, sipas njësive organizative, në pajtim me datën 31.12.2020 është siç vijon:

- këshilltarë shtetërorë – 3
- Sektori i mbështetjes së drejtorit – 6
- Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit – 4
- Sektori i përkthimit dhe i lekturës – 3
- Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore – 2
- Njësia e çështjeve financiare - 0
- Njësia e revizionit të brendshëm – 0

Në Njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në bazë të Programit vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve administrative, të miratuar nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, po përgatitet Plani vjetor për trajnime të nëpunësve administrative, sipas mendimit të marrë nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës.

Tabela 1. Pasqyra e vendeve të punës të sistemuara dhe të plotësuara në AZGJ

Njësitë organizative	Vendet e sistemuara të punës Gjendja më 31.12.2020	Numri i plotësuar i realizuesve Gjendja më 31.12.2020
Këshilltarë shtetërorë	3	3 (1 person përkohësisht është marrë nga një organ tjetër)
Sektori i mbështetjes së drejtorit	16	6 (1 personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës)
Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit	11	4
Sektori i përkthimit dhe i lekturës	26	3
Sektori i punëve juridike, të përgjithshme dhe menaxhimit të burimeve njerëzore	11	2
Njësia e çështjeve financiare	5	0
Njësia e revizionit të brendshëm	2	0

3.3. Struktura e të punësuarve


Plotësimi sipas kategorive të vendeve të punës të nëpunësve administrativë

- nëpunës udhëheqës administrativë – 11;
- nëpunës profesional administrativë – 7;
- nëpunës ndihmës-profesional administrativë – 0;
- persona ndihmës-teknikë – 0.

Plotësimi sipas shkallës së arsimit:

- me arsim të lartë – 18;
- me shkollë të mesme – 0;
- me shkollë fillore – 0.

Grafiku 1. Numri i të punësuarve sipas shkallës së arsimit



Plotësimi sipas strukturës gjinore:

- gjinia femërore – 8
- gjinia mashkullore – 10

Grafiku 2. Struktura gjinore e të punësuarve





Tabela 2. Struktura e të punësuarve në AZGJ në përputhje me 31.12.2020

Kategoritë e vendeve të punës	Gjinia		Shkalla e arsimit		
	M	F	PLP	PMP	Fillore
Udhëheqëse	5	6	11	0	0
Profesionale	5	2	7	0	0
Ndihmëse-profesionale	0	0	0	0	0
Ndihmëse-teknike	0	0	0	0	0
Gjithsej	10	8	18	0	0

Grafiku 3. Struktura e të punësuarve në AZGJ në përputhje me 31.12.2020



4.1. Vështrim i punës

AZGJ gjithmonë synon të sigurojë kryerje të sigurt dhe efektive të detyrimeve ligjore që janë kyç, por edhe të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme përforcimin e kapaciteteve të veta.

Prioritetet kryesore dhe qëllimet zhvillimore të AZGJ-së rrjedhin nga kompetencat e saj ligjore dhe fokusohen në zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të rregullores ligjore për zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, por edhe në rindërtimin dhe përforcimin e saj në aspektin e kapaciteteve për kryerjen e funksioneve të saj. Në këtë kontekst, AZGJ-ja para vetes ka vendosur shumë qëllime strategjike afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të realizohen, siç vijon:

- përcjellje e vazhdueshme e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
- analizë të përvojave më të mira botërore dhe modeleve të shumëgjuhësisë;
- promovim dhe zhvillim të sistemit për zbatim aktiv të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- avancim të funksionimit dhe realizimit të kompetencave të AZGJ-së nëpërmjet sigurimit të përkrahjes administrative, logjistike dhe teknike;
- përforcim të kapaciteteve me burime njerëzore nëpërmjet punësimeve të reja, shpërndarjeve dhe avancimeve, në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe me zbatimin e parimeve të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, si dhe nëpërmjet përsosjes profesionale të të punësuarve në AZGJ;
- përforcim të punës financiare dhe materiale, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit strategjik në AZGJ, e plotësuar me aktivitete për themelimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e udhëheqjes financiare dhe kontrollit;


- përmirësim të punës së AZGJ-së, nëpërmjet rritjes së efektshmërisë së sistemeve për kontroll të brendshëm dhe përputhje të punës me ligjet, me aktet nënligjore dhe me aktet e brendshme;
- themelim të programeve për të punësuarit në AZGJ për zhvillim sistemor të shkathtësive të tyre, njohurive dhe sjelljes, të nevojshme këto për realizimin e qëllimeve afatmesme dhe afatgjata;
- themelim dhe avancim të bashkëpunimit me palët përkatëse të interesuara, duke përfshirë edhe organet shtetërore, dhomat ekonomike, sektorin joqeveritar, bashkësinë e donatorëve, korin diplomatik, organizatat ndërkombëtare.

4.2. Kërkesat e pranuara për përkthim dhe lekturim

Gjatë vitit 2020, në AZGJ janë dorëzuar 60 kërkesa për përkthim dhe 177 kërkesa për lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare.

Numri i kërkesave të arritura për përkthim	Përqindja e përkthimeve të realizuara	Numri i kërkesave të arritura për lekturim	Përqindja e kërkesave të realizuara për lekturim
60	100% (me kryerje të lekturimit të përkthimit)	177	100%


Grafiku 4. Kërkesat e arritura dhe të realizuara për përkthim dhe lekturim në vitin 2020





4.3. Pyetësorët anketues drejtuar institucioneve të sektorit publik

AZGJ-ja gjatë vitit 2020 dorëzoi gjithsej 428 pyetësorë anketues, me një paketë pyetjesh të strukturuara, tek institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal, ku përgjigje kthyese mori nga gjithsej 119 institucione, gjegjësisht 27,80% nga institucionet anketuese.


Në vijim është dhënë një pasqyrë tabelore e rezultateve të marra në lidhje me çdo pyetje të pyetësorit anketues.



1. Vallë, i keni plotësuar detyrimet në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dhe, nëse nuk i keni plotësuar në tërësi, në cilën fazë të implementimit jeni?
119
99
79
59
39
19
-1
70
40
9
Përmbushur
Pjesërisht
Nuk janë përmbushur



2. Nëse nuk keni filluar implementimin, a keni nevojë për ndihmë profesionale nga Agjencia?
119
99
79
59
39
19
-1
15
65
19
20
Po
Jo
S'ka përgjigje
Do të kërkojnë ndihmë nëse ju duhet



3. Vallë, në aktin tuaj të sistematizimit të vendeve të punës, a keni paraparë formë organizative për përkthim dhe lekturim në dhe nga gjuha shqipe?
119
99
79
59
39
19
-1
28
88
3
Po
Jo
Nuk mund të përgjigjen


4. Nëse nuk keni paraparë, a do ta bëni atë në ndryshimin tjetër të aktit të sistematizimit të vendeve të punës?
119
99
79
59
39
19
-1
39
28
10
15
24
3
Po
Jo
S'ka përgjigje
Nëse është e nevojshme
Tanimë e kanë bërë
Nuk mund të përgjigjen


5. Sa përkthyes dhe lektorë keni punësuar në institucionin tuaj?
119
99
79
59
39
19
-1
75
29
8
3
2
1
1
0 përkthyes dhe lektorë
1 përkthyes dhe lektor
2 përkthyes dhe lektorë
3 përkthyes dhe lektorë
4 përkthyes dhe lektorë
6 përkthyes dhe lektorë
20 përkthyes dhe lektorë


6. Vallë, në buxhetin e parashikuar për vitin 2021 a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe lektorë të rinj?
119
99
79
59
39
19
-1
27
63
10
19
Po
Jo
Nuk mund të përgjigjen
S'ka përgjigje


7. Si mund t’ju ndihmojme në përshpejtimin e zbatimit të plotë të Ligjit?
119
99
79
59
39
19
-1
10
19
29
59
2
Po
Jo
S'ka përgjigje
Do të kërkojnë ndihmë nëse kanë nevojë
Nuk mund të përgjigjen


Gjuha e përgjigjes
119
99
79
59
39
19
-1
79
4
36
Përgjigje në maqedonisht
Përgjigje në shqip
Përgjigje në maqedonisht dhe në shqip

4.4. Pyetësori onllajn për përdorimin e gjuhëve zyrtare në gjendje të jashtëzakonshme

AZGJ-ja, në faqen e saj të internetit përgatiti një pyetësor onllajn, qëllimi i të cilit ishte që të vërtetojë nëse qytetarët kanë pasur mundësi të marrin informacione nga administrata publike në gjuhën zyrtare sipas zgjedhjes së tyre, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, të shkaktuar nga pandemia e lidhur me virusin korona SARS-CoV-2 (COVID-19).





Në vazhdim është dhënë pasqyrë e pyetjeve nga pyetësori anketues dhe rezultatet e marra.

1. Në cilin vendbanim/rajon jetoni?

Dëshiroj të mos përgjigjem: 53,85% (7 vota)

Tjetër: 46,15% (6 vota)

Gjithsej: 100,00% (13 vota)

2. Shikuar në përgjithësi, në cilën gjuhë zyrtare dëshironi të merrni informacione nga administrata publike?

Gjuhën maqedonase: 61,54% (8 vota)

Gjuhën shqipe: 38,46% (5 vota)

Gjithsej: 100,00% (13 vota)

3. Sa u takon gjuhëve zyrtare, vallë, keni vështirësi të merrni informacione për shëndetin publik apo për sigurinë nga administrata publike, në gjuhën zyrtare sipas zgjedhjes suaj, gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, siç është pandemia e shkaktuar nga virusi korona COVID-19 (për shembull, gjatë kohës së konferencave për shtyp, të ueb faqeve, në komunikimet me shkrim dhe publikimet etj.)?

Nuk e di / dëshiroj të mos përgjigjem: 50,00% (9 vota)

Jo: 27,78% (5 vota)

Po: 22,22% (4 vota)

Gjithsej: 100,00% (18 vota)

4. Sa jeni të brengosur që nuk e dini nëse do të merrni informacione nga administrata publike në gjuhën zyrtare sipas zgjedhjes suaj, gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme?

Deri diku jam i/e brengosur: 50,00% (5 vota)

Shumë jam i/e brengosur: 30,00% (3 vota)

Pak jam i/e brengosur: 20,00% (2 vota)

Aspak nuk jam i/e brengosur: 0,00% (0 vota)

Nuk e di / dëshiroj të mos përgjigjem: 0,00% (0 vota)

Gjithsej: 100,00% (10 vota)

5. A keni komente të tjera plotësuese për përvojën tuaj gjatë marrjes së informacioneve në gjuhën zyrtare sipas zgjedhjes suaj në gjendje të jashtëzakonshme?

Nuk kam komente plotësuese: 92,31% (12 vota)

Tjetër: 7,69% (1 votë)

Gjithsej: 100,00% (13 vota)

4.5. Regjistri i përkthyesve dhe i lektorëve në sektorin publik

AZGJ-ja përgatiti regjistër të personave me status të nëpunësve administrativë, persona të angazhuar në bazë tjetër apo bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilëve u janë dhënë detyra pune për përkthim dhe lekturim, nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas.

Ky regjistër do t'i shërbejë AZGJ-së, që të krijojë një pasqyrë të plotë të gjendjes me kuadrin e përkthyesve dhe të lektorëve në organet e pushtetit qendror, me qëllim që në të ardhmen edhe ata të mund të përfshihen nëpër programet dhe trajnimet për përkthyes dhe lektorë, që do t'i organizojë AZGJ-ja.

4.6. Trajnim për përdorimin e softuerit të përkthimit – TRADOS

Sistemet elektronike gjithnjë e më shumë po përparojnë në aspektin e punës efikase, ashtu që me trajtimin e përkthyesve, mund t'ju lehtësohet atyre përdorimi i mjeteve elektronike (softuerit), fjalorëve të strukturuar elektronikë,

bazës së integruar të fjalëve të specializuara nga lëmi administrativ, nga lëmi juridik dhe metodat e shpejta dhe të lehta të përkthimit etj. Në këtë mënyrë përkthimi do të jetë më i mirë dhe përkthyesit do të kryejnë punë e tyre në mënyrë efikase.

Me realizimin e qëllimit për efikasitet të përkthimit dhe përmirësimin e cilësisë së tij nga gjuha shqipe në atë maqedonase dhe anasjelltas, të punësuarit në AZGJ, në muajin tetor të vitit 2020 ndoqën trajnimin për përdorimin e softuerit TRADOS, në të cilin gjendet baza e fjalorëve me fjalë të specializuara në shqip dhe në maqedonisht. Qëllimi i softuerit është lehtësimi i procesit të përkthimit, ndaj edhe AZGJ-ja disponon 25 licenca TRADOS për përkthim, të dedikuara posaçërisht për nevojat e AZGJ-së.

4.7. Parashtresat e pranuara

Në vitin 2020, në AZGJ u dorëzuan 14 parashtresa, ku në bazë të përmbajtjes së tyre, u vërtetua nëse ajo është në kompetencë të AZGJ-së. Parashtruesi merr përgjigje profesionale në kohë, e nëse parashtresa nuk është në kompetencë të AZGJ-së, ajo përcillet tek organi kompetent, ku informohet edhe dorëzuesi i parashtresës se te cili organ është dërguar për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për të vepruar sipas saj.

Parashtresat kanë të bëjnë me çështje që lidhen me:

- ueb faqet zyrtare të institucioneve të sektorit publik, të cilat ofrojnë përmbajtje vetëm në një gjuhë zyrtare;

- dilemat në aspektin e përkthimit të drejtë të emrave dhe të emërtimeve;

- mungesa e formularëve në procedurat para organeve publike në gjuhët zyrtare;

- kufizimet në aspektin e zbatimit të gjuhës së vet amtare, që është gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase në komunikim me organet e pushtetit shtetëror.

4.8. Informimi


AZGJ-ja në mënyrë të vazhdueshme ka punuar për ngritjen e vetëdijes së popullatës dhe të institucioneve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjuhësore. Komunikimi u realizua në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët, me sektorin joqeveritar dhe me përfaqësuesit e institucioneve, nëpërmjet formave të ndryshme, si mbledhje, takime pune, takime në terren dhe në forma të tjera të komunikimit.

4.9. Buletini mujor

AZGJ-ja në nivel mujor përgatit buletinin mujor për aktivitetet, me qëllim që të përmirësohet transparenca në punë.

Buletini çdo muaj shpallet në ueb faqen zyrtare të AZGJ-së, në gjuhën maqedonase, atë shqipe dhe në atë angleze, dhe përmban pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve mujore që janë realizuar.







Republic of North Macedonia

Language Implementation Agency of RNM

NEWSLETTER JUN/JUL/AUG 2020

Before you is the first Annual Report on the work of the Language Implementation Agency of the Republic of North Macedonia for the year 2019, presenting a comprehensive review of the activities and joint efforts to improve the protection of language rights, in the better realization of the linguistic rights, the strengthening of the translation capacities of the institutions and the support of all units of local self-government in the Republic of North Macedonia to enable the realization of the linguistic rights of the citizens.

The Cooperation Between LIA and OSCE Mission Continues

LIA's director, Ylber Sela, today had a working meeting via video-conference call with Katarina Zivkovic, a senior program assistant of OSCE Mission in Skopje. The meeting was a great opportunity for the continuation of the dialogue between LIA and OSCE on topics of mutual interest. LIA will continue to be a constructive partner of OSCE in the implementation of project activities which aim to respect the language rights of the citizens and the promotion of European democratic values, stated Sela.

Director Ylber Sela spoke at the unveiling of the memorial plaque in Albanian language at Mother Teresa's house Today in the square of Skopje, exactly the place where Mother Teresa's birth house was once located, it was marked the 40th anniversary of her proclamation as a honorary citizen. On this occasion, a memorial plaque in Albanian language was unveiled there. The director, Ylber Sela, said that starting today the memorial plaque, which marks the place where Mother Teresa was born, is also in Albanian language.Of course, this act also coincides with the official implementation of the Albanian language, a job that has already been successfully completed by the LIA.

The Ambassador of Ukraine visited the Language Implementation Agency

The director of the Language Implementation Agency (LIA), Ylber Sela, hosted a delegation led by Natalia Zadorozhniuk, Ambassador of Ukraine in the Republic of North Macedonia and Roman Buga, First Secretary and Deputy Ambassador. In addition, both sides discussed regarding the possibilities for mutual cooperation through participation in events organized by both sides, as well as exchange of experiences and organizing a study trip to Ukraine.

LIA's library gets enriched with more terminological dictionaries


These days, the Language Implementation Agency has managed to provide some rare dictionaries for its needs, which were published many years ago and are very difficult to find them, Of course, these dictionaries will help translators and proofreaders of the Language Implementation Agency to deal with the work and dilemmas of terminology.

4.10. Ueb faqja zyrtare dhe mediet digjitale

Ueb faqja zyrtare e AZGJ-së - www.apj.gov.mk dhe www.azgj.gov.mk, vazhdimisht përditësohet me përmbajtje informative në 3 (tri) gjuhë, lidhur me aktivitetet e AZGJ-së, me qëllim që të ruhet parimi i transparencës dhe mundësisë së AZGJ-së për qasje te publiku më i gjerë.

AZGJ-ja shpërndan aktivitetet lidhur me punën e saj edhe në rrjetet sociale Facebook dhe në YouTube.


Like
Share
Агенција за примена на јазикот на РСМ
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
Агенција за примена на јазикот / Agjencia e Zbatimit të Gjuhës
@apjazgj
Home
Posts
Reviews
Videos
Photos
About
Агенција за примена на јазикот / Agjencia e Zbatimit të Gjuhës
November 4, 2020 ·
Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, të gjithë fjalorët terminologjikë që i kishte në Institutin e Studimeve Politike dhe Ndërkombëtare (ISPN), ia dhuroi AZGJ-së, për nevojat e përkthyesve dhe të lektorëve.
Shkup, 4.11.2020
***
Директорот на Агенцијата за примена на јазикот (АПЈ), Илбер Села, ги дониpаше сите терминолошки речници со којшто располага Институтот за политички и меѓународни студии (ИПМС), на АПЈ, за потребите на преведувачите и на лектор... See More


YouTube MK
Search
SIGN IN
Home
Trending
Subscriptions
Library
History
Sign in to like videos, comment, and subscribe.
SIGN IN
BEST OF YOUTUBE
Music
Gaming
Movies
News
Live
APJ AZGJ
SUBSCRIBE
HOME
VIDEOS
PLAYLISTS
CHANNELS
DISCUSSION
ABOUT
Uploads PLAY ALL
SORT BY
Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela për Ditën e...
64 views • 1 month ago
Nënshkrim i një memorandum bashkëpunim...
18 views • 1 month ago
Konferenca Shkencore Dita e 3 / Научна конференција 3...
59 views • 2 months ago
Konferenca Shkencore Dita e 2 / Научна конференција 2...
100 views • 2 months ago
Konferenca Shkencore Dita e 1 / Научна конференција 1...
208 views • 2 months ago
Правата на граѓаните на Северна Македонија за...
13 views • 3 months ago
Të drejtat e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për...
10 views • 3 months ago
Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela në shënimin e 111-vjetorit t...
21 views • 1 year ago
Pasditë me Alsat, i ftuar drejtori i Agjencisë për...
30 views • 1 year ago

4.11. Botimet e shtypura dhe ato elektronike të AZGJ-së në vitin 2020



ЈАЗИЧНИ ИЗРАЗИ ВО СЕКОЈДНЕВНИ СИТУАЦИИ

SHPREHJE GJUHËSORE NË SITUATAT E PËRDITSHME

Основни изрази	Shprehje themelore
Да.	Po.
Не.	Jo.
Благодарам.	Falemnderit.
Молам. / Повелете и друг пат.	Ju lutem. / Urdhëroni edhe herave të tjera.
Повели. / Повелете.	Urdhëro. / Urdhëroni.
Извини. / Извинете.	Më fal. / Më falni.
Молам?	Ju lutem?
Здраво.	Tungjatjeta.
Довидување.	Mirupafshim.
Добро утро.	Mirëmëngjesi.
Добар ден.	Mirëdita.
Добра вечер.	Mirëmbrëma
Како си / сте?	Si je / jeni?
Благодарам, добро сум. Како си ти / сте вие?	Falemnderit, jam mirë. Si je / jeni?
Добра ноќ.	Natën e mirë.
Ке се видиме.	Do të shihemi.

Изрази при запознавање	Shprehje gjatë njohjes
Јас сум...	Unë jam...
Дали можам да се претставам?	A mund të prezentohem?
Дали можам да го претставам господинот...?	A mund ta prezentoj zotërinjtë...?
Ова е...	Ky është...
Како се викаш?	Si e keni emrin?
Мило ми е.	Jam i lumtur.
Од каде си / сте?	Nga je / jeni?
Јас сум од...	Unë jam nga...
Каде живееш / живеете?	Ku jeton / jeton?

Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ

Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

УЧИМЕ АЛБАНСКИ

MËSOJMË SHQIP

ЛЕКЦИЈА 1 / MËSIMI 1

1. **Прочитај ги поздравите под сликата!**
   Lexo përshëndetjet nën fotografi!


Tungjatjeta


Mirëmëngjesi


Mirëdita


Mirëmbrëma

ВНИМАНИЕ! KUJDES!

Поздравот **mirëmëngjesi** се користи наутро.
Поздравот **mirëdita** се користи од наутро до навечер.
Поздравот **mirëmbrëma** се користи навечер.
Поздравот **tungjatjeta** се користи во секое време. Поздравот **tungjatjeta** е во еднина, а во множина е **Jungjatjeta**. Во секојдневниот живот, особено од младите се користи и поздравот **tung, tjeta, njatjeta** како скратенки. **Tung** се користи и при разделба.

2. **Напишете го точниот збор под секоја слика!**
   Shkruaj fjalën e saktë nën secilën fotografi!

Mollë, kivi, banane, ananas, shalqi, limon


_____


_____


_____

2

Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ

Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

КОМУНИКАЦИСКА СТРАТЕГИЈА

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT



2020

Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ

ПРИРАЧНИК

Програма за обука за превод и толкување од македонски на албански и од албански на македонски јазик и за лектори по албански јазик

Скопје, 2020

Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

MANUAL

Program trajnimi për përkthim dhe interpretim maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht dhe lektorë të shqipes

Shkup, 2020

Republic of North Macedonia
Language Implementation Agency of RNM

HANDBOOK

Translation & Interpretation Training Program Macedonia-Albanian and Albanian-Macedonian and for proofreaders of the Albanian language

Skopje, 2020

4.12. Pasqyrë e akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" në vitin 2020

Në përputhje me nenin 17, paragrafi (1) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/2019), të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, që shpallen në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", shpallen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

AZGJ-ja përgatiti pasqyrë statistikore të të gjitha akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", që përbëhet nga institucionet sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në bazë të pasqyrës së përgatitur, është vërtetuar përqindja e përputhjes së institucioneve në aspektin e implementimit të detyrimit sipas nenit 17 të ligjit.

Nr. rendor	EMRI I INSTITUCIONIT	Gjithsej botime të shpallura	Botime të shpallura vetëm në gjuhën maqedonase	Botime të shpallura në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj	Përqindja e pëlqimit me detyrimin sipas nenit 17 të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (%)
1	QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	220	220	0	0%
2	KRYETARI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	28	28	0	0%
3	KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	48	6	42	87,50%
4	MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE	32	32	0	0%
5	MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE E ADMINISTRATËS	14	14	0	0%
6	MINISTRIA E FINANCAVE	20	20	0	0%
7	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	23	23	0	0%
8	MINISTRIA E DREJTËSISË	25	25	0	0%

9	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE E EKONOMISË SË UJËRAVE	25	25	0	0%
10	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	8	8	0	0%
11	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	6	6	0	0%
12	MINISTRIA E EKONOMISË	7	7	0	0%
13	MINISTRIA E MBROJTJES	3	3	0	0%
14	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS	21	21	0	0%
15	MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E LIDHJEVE	8	8	0	0%
16	MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE	3	3	0	0%
17	MINISTRIA E KULTURËS	1	1	0	0%
18	BANKA POPULLORE	9	9	0	0%
19	AGJENCIA E KADASTRËS SË PATUNDSHMËRIVE	17	17	0	0%
20	AGJENCIA E USHQIMIT DHE E VETERINARISË	55	41	14	25,45%
21	AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT	13	13	0	0%
22	AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMIT PENSIONAL TË FINANCUAR NË MËNYRË KAPITALE	6	6	0	0%
23	AGJENCIA E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	7	7	0	0%
24	AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE, AUDIO DHE AUDIOVIZUALE	8	8	0	0%
25	AGJENCIA E MBROJTJES SË TË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË TEK INFORMACIONET ME KARAKTER PUBLIK	3	3	0	0%
26	AGJENCIA E TË RINJVE DHE E SPORTIT	3	3	0	0%
27	AGJENCIA E FLUTURIMEVE CIVILE	7	7	0	0%
28	AGJENCIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE	2	2	0	0%

29	AGJENCIA E POSTAVE	1	1	0	0%
30	AGJENCIA E BARNAVE	1	1	0	0%
31	AGJENCIA E PUNËSIMIT	1	1	0	0%
32	KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË	33	9	24	72,73%
33	KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT	107	60	47	43,93%
34	FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR	12	11	1	8,33%
35	FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	3	3	0	0%
36	KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE	11	10	1	9,09%
37	ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS	13	13	0	0%
38	GJYKATA KUSHTETUESE	32	32	0	0%
39	KËSHILLI I PROKURORËVE PUBLIKË	15	15	0	0%
40	KËSHILLI GJYQËSOR	26	26	0	0%
41	KOMISIONI I MBROJTJES SË KONKURRENCËS	5	5	5	100%
42	DHOMA E NOTERËVE	2	2	0	0%
43	DREJTORIA E MBROJTJES DHE E SHPËTIMIT	3	3	0	0%
44	DHOMA E MJEKËVE	1	1	1	100%
45	DHOMA E AVOKATËVE	2	2	0	0%
46	DREJTORIA E ZONAVE TË ZHVILLUARA TEKNOLOGJIKE- INDUSTRIALE	2	2	0	0%
47	DREJTORIA E SIGURISË SË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA	8	8	0	0%
48	AKADEMIA E TRAJNIMIT TË GJYKATËSVE DHE TË	4	4	0	0%

	PROKURORËVE PUBLIKË				
49	DHOMA E STOMATOLOGËVE	2	2	0	0%
50	DHOMA E FARMACISTËVE	2	2	0	0%
51	INSPEKTORATI SHTETËROR SANITAR DHE SHËNDETËSOR	3	3	0	0%
52	ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT	1	1	0	0%
53	PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	0	0%
54	DREJTORIA E FARËS DHE MATERIALIT MBJELLËS	3	3	0	0%
55	SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT	2	2	0	0%
56	SHA MEPSO	6	6	0	0%
57	FONDI I INOVACIONEVE DHE I ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK	1	1	0	0%
58	SHA NË PRONËSI SHTETËRORE M-NAV	2	2	0	0%
59	INSTITUTI I INXHINIERISË SË TËRMETEVE DHE I SEIZMOLOGJISË INXHINIERIKE	1	1	0	0%
60	KËSHILLI I NDARJES SË ÇMIMIT SHTETËROR “22 NËNTORI“	2	2	0	0%
61	KOMISIONI LIGJVËNËS-JURIDIK I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	0	0%
62	RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË	1	1	0	0%
63	GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	2	2	0	0%
64	KOMISIONI I ÇËSHTJEVE TË ZGJEDHJEVE DHE I EMËRIMEVE I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	1	100%
65	NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE	9	9	0	0%

5.1. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara

AZGJ-ja në vitin 2020 realizoi bashkëpunim me një numër të madh institucionesh dhe organizatash nëpërmjet takimeve të punës, ngjarjeve, konferencave për shtyp, takimeve onllajn, sado që punohej në kushte të kufizuara dhe restrikcione në aspektin e lëvizjes dhe kufizimeve në udhëtime apo realizim të vizitave zyrtare, ngjarjeve, takimeve, shkaktuar nga pandemia globale e virusi koronat SARS-*CoV*-2 (Covid-19).

Në vazhdim është raporti i shfaqur si përmbledhje e ngjarjeve të realizuara, takimeve dhe aktiviteteve në vitin 2020.

5 janar 2020

Dita e "Mesharit" të Gjon Buzukut – libri i parë në gjuhën shqipe

Pesë janari është i njohur si dita e librit të parë në gjuhën shqipe, "Meshari" - 1555 (fjalë shqipe për meshë) i Gjon Buzukut. Siç pohon edhe vetë autori, librin e ka filluar më 20 mars 1554 dhe e ka përfunduar më 5 janar 1555. Librin e shkroi për shërbimet fetare në gjuhën shqipe, respektivisht "enseh dashunit te botese saneh", siç pohon edhe vetë autori. Por, për shkak të rrethanave historike, libri ishte lënë pas dore deri në vitin 1740, kur në bibliotekën e propagandës Fide, e zbuloi kryepeshkopi i Shkupit, Gjon Nikoll Kazazi.



Nga ky vit u bë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të shqiptarëve. Pa dyshim, "Meshari" është baza e identitetit kulturor, gjuhësor dhe civilizues të shqiptarëve. Për shkak të rëndësisë së madhe të këtij libri, pesë janari duhej të ishte data e përkujtimit të të gjithë atyre, që

gjatë historisë u torturuan apo ranë dëshmorë për ta mbajtur gjuhën shqipe të gjallë, bazë kjo e identitetit tonë kombëtar, me të cilin shqiptarët patën sukses të mbijetojnë deri sot, duke shpëtuar nga asimilimi.

8 janar 2020

Drejtori Sela i dorëzoi formularët përfaqësuesit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor

Sot në Shkup, Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës e vizitoi përfaqësuesi i Fondit të Sigurimit Shëndetësor, Arben Saliu, i cili u prit nga drejtori Ylber Sela. Me këtë rast, ky i fundit ia dorëzoi formularët e lekturuar në gjuhën shqipe nga shërbimet e AZGJ-së, formularë këta që i përkasin sferës shëndetësore. Kujtojmë se nga takimi i fundit që patëm në këtë institucion, zbatimi i gjuhës shqipe haste në vështirësi dhe pengesa objektive për shkak të veprimtarisë shumë të gjerë në mbarë vendin, por të cilat së shpejti do të tejkalohen.



9 janar 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, u takua me drejtorin e Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve, Fatmir Iseni

Gjatë ditës së sotme, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela pati një takim me drejtorin e Inspektoratit të Gjuhëve, Fatmir Iseni, ku ishte i pranishëm edhe sekretari shtetëror i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, Adem Avziu.



Gjatë këtij takimi u shqyrtuan mundësitë e bashkëpunimit me Inspektoratin e Gjuhëve, si një institucion i sapoformuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Në të vërtetë, takimi në fjalë kishte si qëllim mbështetjen e plotë të drejtorit të ri, si dhe për t'i ofruar ndihmë të vazhdueshme gjatë ballafaqimit me detyrat dhe sfidat e ndryshme që e presin në punën e Inspektoratit të Gjuhëve.

14 janar 2020

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) në RMV, e promovon këtë botim: "Udhëzues i zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve". Udhëzuesi është botuar në 4.000 kopje në tri gjuhë: në gjuhën shqipe, atë maqedonase dhe atë angleze.



Udhëzuesi përmban fjalën hyrëse të drejtorit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i cili i sqaron synimet dhe qëllimet për përmirësimin e komunikimeve në mes qytetarëve dhe institucioneve në vend, si dhe sqarim të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, i cili e rregullon përdorimin e gjuhës shqipe në komunikimin e përditshëm të qytetarëve me institucionet shtetërore. Ky ligj në mënyrë të përpiktë përcakton se ku dhe në çfarë mënyre përdoret gjuha shqipe, si dhe detyrimet e institucioneve për zbatimin e tij. Gjithashtu, Udhëzuesi e shpjegon edhe rolin e AZGJ-së në zbatimin e gjuhës shqipe.

Në fund përmban një fjalor të vogël të nocioneve administrative, maqedonisht – shqip, që është parashikuar ta lehtësojë punën e të punësuarve dhe të qytetarëve gjatë përmbushjes së nevojave dhe detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore. Qëllimi i udhëzuesit është që të shërbejë edhe si mjet praktik për lehtësimin e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet e pushtetit qendror dhe atij lokal.

15 janar 2020

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela, në promovimin e Udhëzuesit për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve

"Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që të them pak fjalë për Udhëzuesin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, të parin e këtij lloji këtu te ne, me qëllim që të sjellë në një vend legjislacionin, politikat dhe rolin e strukturave institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që procesi i respektimit të së drejtës për përdorimin e gjuhës shqipe, si një e drejtë themelore e shqiptarëve, të zbatohet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, gjë që është në

interesin dhe stabilitetin e kësaj shoqërie ku jetojmë. Para së gjithash kjo do të kontribuojë dukshëm në aspektin e paraqitjes sa më të mirë të institucioneve, për një imazh sa më pozitiv dhe për një nivel sa më të lartë të funksionimit të ligjit.

Gjatë viteve që kemi lënë pas, institucionet e larta shtetërore janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar bazën e mjaftueshme ligjore lidhur me përdorimin zyrtar të gjuhëve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Siç e kemi të njohur, Republika e Maqedonisë së Veriut tanimë ka një legjislacion më të avancuar, i cili rregullon më qartë përdorimin e gjuhëve në institucione. Dhe sado që është kompletuar kjo infrastrukturë ligjore për përdorimin e gjuhëve, prapëseprapë, gjatë zbatimit praktik shfaqen vështirësi dhe sfida të ndryshme. Në të vërtetë, ky udhëzues nuk e ndryshon ligjin që është në fuqi, por bën një shpjegim të qartë për sa i përket zbatimit të tij në praktikën shoqërore.

Prandaj, të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve, politikëbërësit, planifikuesit dhe praktikuesit kanë në duar një mjet lehtësues për t'u qasur në informacionet që kanë të bëjnë me detyrimet institucionale ndaj të drejtave të qytetarëve për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më lejoni të falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre të çmuar në hartimin e këtij udhëzuesi.









16 janar 2020

Drejtori Sela në takim pune në Gjykatën Supreme



Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, ishte në vizitë pune në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të Faik Arsllanit, ushtruesi i detyrës së kryetarit të gjykatës më të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbledhje në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të Gjykatës Supreme, Lidija Tanevska – Jadrovska, këshilltare e pavarur gjyqësore dhe shefja e kabinetit të kryetarit të gjykatës, Sonja Gruevska, administratore gjyqësore dhe Marina Mileva, bashkëpunëtore e lartë gjyqësore dhe zëdhënëse e gjykatës. Drejtori Sela i falënderoi për ftesën e takimit dhe theksoi se gjithnjë është i hapur për bashkëpunim dhe mbështetje të çdo institucioni që ka nevojë, kjo me qëllim që t'u mundësohet qytetarëve realizim efikas dhe efektiv të të drejtave të tyre gjuhësore dhe të procedurave në Gjykatën Supreme, ashtu siç është paraparë me ligj.

Kryetari Arsllani shprehu mbështetje për punën e AZGJ-së dhe njëherësh e informoi bashkëbiseduesin se edhe përkundër vonesave dhe pengesave në zbatimin

e ligjit, janë ndërmarrë aktivitete nga Gjykata Supreme, siç është ndryshimi i tabelës së gjykatës në gjuhët zyrtare, aktivitetin e tanishëm për ndryshimin e vulave, të logos dhe uebfaqen e gjykatës, aktivitete të cilat priten të mbarojnë në kohë sa më të shkurtër.



Gjithashtu theksoi nevojën e ekipimit të kuadrit të gjykatës, me angazhimin e përkthyesve dhe lektorëve të specializuar në terminologjinë gjyqësore, krejt kjo me qëllim të funksionimit të gjykatës dhe zbatimin e mirëfilltë të dispozitave ligjore, të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurat gjyqësore.

Gjatë kohës së takimit, të dyja palët e riafirmuan nevojën për bashkëpunim dhe mbështetje të ndërsjellë, duke e theksuar rëndësinë e respektimit të të drejtave ligjore të çdo qytetari.

23 janar 2020

AZGJ-në e vizitoi një delegacion i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor

Sot, Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës e vizitoi një delegacion i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, i kryesuar nga shefi i kabinetit, Muharem Asani, i cili u prit nga drejtori i Agjencisë, Ylber Sela.

Institucioni në fjalë pasi e ka pranuar Udhëzuesin, që Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e promovoi ditë më parë, ka shfaqur interes për t'u njohur nga afër me punën e Agjencisë, por dhe për t'i sqaruar dilemat dhe pengesat që shfaqen gjatë zbatimit të gjuhës në këtë institucion të rëndësishëm dhe kompleks.

Gjatë takimit u fol për shumë çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e dygjuhësisë në atë institucion, veçmas për vështirësitë dhe dilemat që shfaqen gjatë këtij procesi.

Faza e parë e zbatimit të dygjuhësisë në FSPI tanimë ka përfunduar, por edhe faza e dytë pritet së shpejti t'i tejkalojë vështirësitë dhe pengesat për shkak të veprimtarisë shumë të gjerë në mbarë vendin.







Të dyja palët shfaqën interes për bashkëpunim në të ardhmen dhe se duhet të zbatohet ajo që është përcaktuar me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Me këtë rast, drejtori Ylber Sela ofroi ndihmë konkrete për sa i përket përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve dhe formularëve të ndryshëm për nevojat e këtij institucioni.

29 janar 2020

Drejtori Sela e vizitoi BNU "Shën Klementi i Ohrit"

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Bibliotekën Nacionale dhe Universitare "Shën Klementi i Ohrit", ku pati një takim pune me Frymëzim Dautin, drejtorin e këtij institucioni.

Me këtë rast, drejtori Sela shprehu mirënjohjen për takimin, si dhe gatishmërinë e AZGJ-së për bashkëpunimin ndërinstitucional, për mendime këshilluese, për konsultime dhe përkrahje të punës së BNU "Shën Klementi i Ohrit".



Nga ana tjetër, Dauti informoi homologun e tij se bibliotekës i mungon personeli për përkthim dhe korrigjim në gjuhët zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe se do të bëhen përpjekje që me burimet e brendshme në dispozicion të bibliotekës, të sigurohet respektimi i dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Palët shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar më tej dhe për të promovuar bashkëpunimin e mirë midis dy institucioneve.

29 janar 2020

Takim pune i drejtorit Sela në MPB

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, zhvilloi një takim pune në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), ku u takua me Xhevdet Azizin, ndihmësministër i Departamentit të çështjeve civile, Lidija Petrova–Mojsovska, kryeshefe e Sektorit të armëve, të materialeve shpërthyese dhe të rrezikshme, Nadica Velevska, kryeshefe e Sektorit të çështjeve administrative – mbikëqyrëse, Elizabeta Popovska–Tomovska, Sllavica Mihajllovska dhe Besim Gjureci, përfaqësues të departamenteve përkatëse të Sektorit të çështjeve administrative – mbikëqyrëse.

Në takimin e punës u diskutuan çështje që lidhen me zbatimin e gjuhëve zyrtare, veçanërisht në procedurat civile, lëshimin e akteve administrative, përgatitjen e kërkesave, certifikatat, lejet, mbajtjen e shënimeve dhe regjistrave të ministrisë, si dhe çështje të tjera me interes të të dyja palëve.



Me këtë rast, drejtori Sela shprehu interes për bashkëpunim dhe ofroi ndihmë konkrete për përkthimin dhe lekturimin e formularëve dhe shablloneve të ndryshme për nevojat e ministrisë, dhe përshëndeti angazhimin e ndihmësministrit Azizi dhe bashkëpunëtorëve të tij në zbatimin e detyrimeve të

zgjidhjes ligjore të përdorimit të gjuhëve, që të realizohen të drejtat e qytetarëve në gjuhët zyrtare dhe në procedurat për të cilat është përgjegjëse MPB-ja.


3 shkurt 2020


Drejtori Sela vizitoi Institucionin Kombëtar "Ansambli i Këngëve dhe i Valleve Popullore Shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela e vizitoi Ansamblin Nacional të Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (ANKVPSH), ku u prit nga homologu i tij, Shkodran Tolaj.

Në këtë takim pune, drejtori i ANKVPSH-së, Shkodran Tolaj e njoftoi drejtorin e AZGJ-së, Ylber Sela lidhur me përmbushjen e detyrimit ligjor për sa i përket dygjuhësisë, duke filluar që nga vulat, logoja e deri te tabela me emrin e institucionit. Po ashtu, ai foli edhe për fazën e mëtejme për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Me këtë rast drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela ofroi ndihmën e tij, si dhe gatishmërinë për sa i përket bashkëpunimit në aspektin e zbatimit të dygjuhësisë në këtë institucion.




4 shkurt 2020

Drejtori Sela e vizitoi Gjykatën e Lartë Administrative

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGJ), Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi Gjykatën e Lartë Administrative (GJLA), ku u takua me kryetaren e saj, Ismeta Amet dhe gjykatësin Subhi Jakupi.

Në takim u diskutua për nivelin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion gjyqësor. Kryetarja Amet dhe gjykatësi Jakupi e informuan drejtorin Sela për sfidat me të cilat përballet institucioni, duke theksuar se ka mungesë personeli për përkthimin e dokumenteve zyrtare, por që janë ndërmarrë veprime për të ndryshuar tabelën dhe vulat.




Ata deklaruan se në bashkërendim me Këshillin Gjyqësor të RMV-së do të ndërmarrin veprime për të zbatuar dispozitat ligjore që lidhen me përdorimin e gjuhëve zyrtare edhe në procedurat gjyqësore.

Drejtori Sela shprehu gatishmërinë për të mbështetur gjykatën në realizimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve në procedurat për të cilat ky institucion është kompetent.

5 shkurt 2020

Drejtori Ylber Sela e vizitoi FSPIMV-në

Sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, në shoqërinë e bashkëpunëtorëve të vet, e vizitoi Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (FSPIMV), ku u prit nga kolegu i tij Shaip Zeneli me bashkëpunëtorët e ngushtë.

Në këtë takim pune u bisedua për realizimin e detyrimit ligjor të institucioneve shtetërore në aspektin e dygjuhësisë. Drejtori i FSPIMV-së, Shaip Zeneli, e informoi kolegun e tij për dinamikën e dygjuhësisë në këtë institucion. Gjithashtu, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela tregoi gatishmëri për të ndihmuar në përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve zyrtare për nevojat e këtij institucioni.





Gjatë kësaj vizite u vu re se në hyrjen e FSPIMV-së të gjitha tabelat janë të shkruara në dy gjuhë. Pa dyshim, faza e parë është zbatuar më herët, kurse në vijim është faza e dytë. Prej këtu, mund të themi se ky institucion është një shembull i mirë lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, të cilin duhet ta ndjekin edhe institucionet e tjera që akoma nuk kanë filluar me zbatimin e tij.

Me këtë rast, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, në fund shpërndau disa broshura në dy gjuhë për nevojat e qytetarëve, me qëllim që ata të jenë të informuar pikërisht për të drejtat e tyre gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

11 shkurt 2020

Drejtori Sela vizitoi EVN-në

Me këtë rast, drejtori Sela e falënderoi për mundësinë e takimit të drejtpërdrejtë duke theksuar se EVN-ja është një shembull i shkëlqyer i afarizmit, si kompani me përgjegjësi shoqërore në një mjedis shumetnik dhe shumëgjuhësh, që mbështet dhe zbaton shumëgjuhësinë në aktivitetet dhe shërbimet që kjo korporatë ua ofron konsumatorëve të saj.





Nga ana tjetër, Peter e informoi drejtorin Sela për ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë në mënyrë të barabartë për të gjithë konsumatorët, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre etnike ose gjuhësore dhe se në këtë aspekt EVN-ja është një shembull edhe për të tjerët në një mjedis që i afirmon dhe respekton dallimet dhe vazhdimisht promovon proceset afariste në drejtim të ofrimit të cilësisë më të lartë të shërbimeve për konsumatorët e saj.

12 shkurt 2020

Takim pune i drejtorit Sela me ministren e Punës dhe të Politikës Sociale, Mizrahi

Drejtori i Agjencisë së Zbatimi të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale (MPPS) ku zhvilloi një takim pune me ministren Rashela Mizrahi.

Gjatë këtij takimi, drejtori Sela theksoi se AZGJ-ja është gjithmonë e hapur për bashkëpunim ndërinstitucional, përfshirë këtë me MPPS-në si një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm. Është me rëndësi të veçantë për ministrinë që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në interesin e qytetarëve. Në të njëjtën kohë, drejtori Sela i ofroi mbështetje ministrisë në përkthimin dhe verifikimin e formularëve, formave dhe kërkesave zyrtare që qytetarët i përdorin gjatë realizimit të të drejtave të tyre në procedurat e nevojshme.



Ministrja Mizrahi shprehu kënaqësi për takimin dhe shfrytëzoi rastin për të informuar drejtorin Sela për situatën e trashëguar nga aspekti i zbatimit të zgjidhjes ligjore për gjuhët dhe njëkohësisht u zotua se do të përmirësojë situatën dhe do të rrisë më tej bashkëpunimin midis dy institucioneve.

20 shkurt 2020

Filloi punimet konferenca shkencore me rastin e Ditës së Gjuhës Amtare

Sot në orët e pasdites, në hotelin "Holiday Inn" në Shkup u hap solemnisht Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV", në organizim të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së me rastin e Ditës Botërore të Gjuhës Amtare. Hapjen e bëri drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili u dëshiroi mirëseardhje pjesëmarrësve

duke u përqendruar shkurtimisht në punën e deritashme të institucionit të cilin e udhëheq, si dhe në qëllimin e mbajtjes së kësaj konference.

Në vazhdim, të pranishmit i përshëndeti edhe kryetari i Kuvendit të RMV-së, Talat Xhaferi, zëvendëskryeministri i RMV-së dhe ministri i Sistemit Politik dhe i Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, Sadulla Duraku, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi dhe drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Skender Asani.

Me këtë rast u nënshkruan edhe dy memorandume bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së të kryesuar nga drejtori Ylber Sela, dhe Universitetit të Europës Juglindore të kryesuar nga rektori Abdylmenaf Bexheti, dhe Universitetit "Nënë Tereza" të kryesuar nga sekretari i përgjithshëm, Bujar Kajolli. Më herët, AZGJ-ja ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Universitetin e Tetovës, me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Sipas agjendës, konferenca në fjalë vazhdoi punimet me leximin e kumtesave lidhur me sfidat e përkthimit. Për këtë çështje folën Izer Maksuti nga Universiteti i Prizrenit dhe Ajten Hajdari Qamili nga Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi".

Konferenca i vazhdon punimet edhe gjatë dy ditëve të ardhshme.










21 shkurt 2020

Vazhdon konferenca shkencore e AZGJ-së

Konferenca shkencore me temë "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV", e cila u hap dje, vazhdoi punën edhe gjatë ditës së sotme. Fjalë përshëndetëse patën drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, ish-zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, zëvendësdrejtori i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive, Xhelal Hoxhiq dhe Rami Memushaj – gjuhëtar nga Shqipëria.

Pas kësaj filloi paneli i parë me temë "Modelet europiane të politikave gjuhësore", ku folën ambasadorja e Zvicrës, Sybille Suter Tejada, ambasadori i Finlandës, Kimo Lahdevirta dhe ambasadori i Kosovës, Gjergj Dedaj.
Në panelin e dytë, me kumtesa u paraqitën Petra Malfertheiner, e cila foli për të drejtat gjuhësore në Tirolin Jugor në Itali, Besim Kabashi, për nevojën e një korpusi paralel për nxjerrjen e terminologjisë për gjuhën shqipe, Izer Maksuti foli për përdorimin e gjuhës sipas modeleve të politikës gjuhësore të Tirolit Jugor dhe të Belgjikës, si dhe Zeqirija Ibrahimi, për politikat gjuhësore europiane në përqasje me politikën gjuhësore të RMV-së.

Në panelin e tretë me temë "Shumëgjuhësia në RMV", me kumtesat e tyre u paraqitën Abel Andrea, e cila foli lidhur me edukimin në dy e më shumë gjuhë në Tirolin e Jugut, Emil Lafe, për sfidat e shqipes letrare në RMV në rrethanat e dygjuhësisë zyrtare, Rami Memushaj, për standardet e dyfishta të dygjuhësisë në Ballkan, Veronika Kareva, për qasjen ndaj mësimit të gjuhës si motivim për popullarizimin e gjuhës shqipe te nxënësit me gjuhë amtare maqedonase dhe prindërit e tyre, Dimitar Pandev, për teorinë e shumëgjuhësisë në gjuhësinë maqedonase.

Në panelin e katërt, me temë "Rëndësia e përkthimit cilësor dhe fjalorët terminologjikë", u paraqitën Klara Kranebitter, e cila foli për punën e terminologjisë në Tirolin Jugor dhe sistemin e informacionit për terminologjinë juridike BISTRO, Ajten Hajdari Qamili, për nevojën e njësimit të terminologjisë administrative dhe përfshirjen e tyre në fjalorët terminologjikë, Edlira Bushati, për shprehjet frazeologjike, si transfer ndërkulturor shqip-gjermanisht, gjermanisht-shqip, Asllan Hamiti, për redaktimin profesional dhe gjuhësor të përkthimeve. Konferenca do të vazhdojë me punë edhe gjatë ditës së nesërme.


Holiday Inn
SKOPJE
Kimo Lahdevirta

22 shkurt 2020

Përfundoi konferenca shkencore për Ditën e Gjuhës Amtare

Konferenca shkencore me temë "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV", e cila u hap pardje, vazhdoi punën e saj edhe gjatë ditës së sotme. Në panelin e parë me temë "Sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV", fjalë përshëndetëse mbajtën drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, kryetari i Gjykatës Administrative, Burim Sejdini dhe profesori universitar Jusuf Zejneli i cili, në mes të tjerash, foli edhe për sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV.

Në panelin e dytë folën Adnan Jashari, i cili u përqendrua në aspektin juridiko-normativ të përdorimit të gjuhëve në RMV, Mimoza Kore, e cila foli për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve në RMV si dhe për sfidat e statusit të shqipes në këtë kontekst, Jusuf Zejneli, për sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV, Anila Omari, foli për përkthimin si faktor ndikimi në zhvillimin gjuhësor dhe për pasojat e përkthimit në shqipen e RMV-së dhe Vebi Bexheti për dilemat e zbatimit të drejtë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Në panelin e tretë, për çështjen e sfidave të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve foli Jasmina Trajkovska-Naumovska, Haki Ymeri foli për shqipen e Maqedonisë së Veriut si gjuhë e 20-përqindshit, ndërsa Demush Bajrami foli për sfidat e shtrirjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Në panelin e katërt me temë "Efektet e shumëgjuhësisë në aktet juridike" folën Sllavisha Mlladenoviq, i cili u ndal në dygjuhësinë në Kosovë, Ismet Osmani, i cili foli për problemet kuptimore në terminologjinë e administratës publike, Berton Sulejmani për toponiminë e tabelave rrugore, ndërsa Ismail Hamiti foli për përkthimin e lirë dhe atë të fjalëpërfjalshëm.

Pas përfundimit të punimeve të konferencës, pjesëmarrësit vizituan disa monumente kulturore në Shkup.


Holiday Inn
SKOPJE

26 shkurt 2020

OSBE-ja me mbështetje konkrete për punën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, realizoi takim pune me Tatjana Temelkoskën, përfaqësuese e Misionit të OSBE-së në Shkup. Takimi i punës paraqet vazhdimësi të dialogut të rregullt dhe bashkëpunimit të mirë ndërmjet AZGJ-së dhe OSBE-së.





Përfaqësuesja e OSBE-së Temelkoska informoi se OSBE-ja do të sigurojë mbështetje të AZGJ-së në organizimin e sesionit, përkatësisht në trajnimin për përgatitjen e Planit strategjik shumëvjeçar për punë të AZGJ-së, i cili do të organizohet në tremujorin e dytë të vitit 2020, ndërkaq do të sigurohen edhe publikime të OSBE-së të cilat do të dhurohen për rritjen e fondit të bibliotekës të cilin AZGJ-ja e ka në dispozicion.

OSBE-ja do të vazhdojë të bashkëpunojë edhe me trupin operativ ekzistues për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm ku drejtori Sela është anëtar, si dhe me trupin koordinues për përgatitje dhe ndjekje të implementimit të strategjisë nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm.

Drejtori Sela u falënderua për mbështetjen duke theksuar se qëllimi i përbashkët është promovimi i dialogut ndëretnik dhe bashkëjetesës nëpërmjet gjuhëve dhe se AZGJ-ja edhe më tutje mbetet e hapur për thellimin e bashkëpunimit të shkëlqyer me OSBE-në.

27 shkurt 2020

ITSHKSH-ja i dhuroi një fond librash AZGJ-së



Sot, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, i dhuroi Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së një numër të konsiderueshëm librash e revistash. Botimet e këtij institucioni shkencor e kulturor i solli drejtori i tij, Skender Asani me disa nga bashkëpunëtorët e tij të ngushtë.

Me këtë rast, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, e falënderoi homologun e tij për këtë ndihmesë të çmuar me të cilën pasurohet biblioteka e institucionit që e udhëheq dhe njëkohësisht shkëmbyen edhe mendime e ide lidhur me bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy institucioneve.



28 shkurt 2020

Drejtori Sela e vizitoi Agjencinë e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Agjencinë e Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore (MALMED), ku realizoi takim pune me drejtoreshën Visara Riza.

Në takim, drejtori Sela theksoi se AZGJ-ja gjithmonë do të mbetet e hapur për bashkëpunim, përfshirë edhe MALMED-in si një organ jashtëzakonisht i rëndësishëm i administratës shtetërore, qëllimi i të cilit është mbrojtja e shëndetit

të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të rregullativës dhe të mbikëqyrjes efikase në fushën e prodhimit dhe qarkullimit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore.



Takimi ishte një mundësi për t'u informuar rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e MALMED-it. Njëkohësisht, drejtori Sela u interesua edhe rreth mundësisë që qytetarët, të cilët janë konsumues të barnave dhe të pajisjeve mjekësore, udhëzimet për përdorim të mund t'i marrin edhe në gjuhët zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtoresha Riza shprehu kënaqësi për takimin dhe shfrytëzoi rastin për ta informuar drejtorin Sela për situatën aktuale në MALMED duke shfaqur interesim për vazhdimin e dialogut ndërmjet dy institucioneve.

28 shkurt 2020

Takim i drejtorit Sela në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, e vizitoi Drejtorinë e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit (DMSH), ku realizoi takim pune me drejtorin Adnan Xhaferoski.



Në takim u diskutuan çështje që lidhen me zbatimin e zgjidhjes ligjore për përdorimin e gjuhëve në punën e përditshme të drejtorisë.
Me këtë rast, drejtori Sela u informua nga drejtori Xhaferoski për situatën në këtë institucion dhe ofroi ndihmë profesionale në pjesën e përkthimit dhe të lekturimit të botimeve zyrtare për nevojat e drejtorisë.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar dhe forcuar edhe më tej bashkëpunimin midis dy institucioneve.

2 mars 2020

Drejtori Sela mori pjesë në shënimin e 576-vjetorit të Lidhjes së Lezhës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela sot mori pjesë në shënimin e 576-vjetorit të Lidhjes së Lezhës, të organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, ku njëkohësisht u bë edhe promovimi i veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe botuese të këtij institucioni gjatë vitit 2019.




Për rëndësinë e kësaj date të shënuar folën disa nga personalitetet e jetës sonë institucionale, shkencore, kulturore e arsimore duke vënë në pah edhe punën mjaft të suksesshme të këtij instituti.

2 mars 2020

Pasardhësi i heroit kombëtar Hasan Prishtina e vizitoi AZGJ-në

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës qëndroi Mehmet Prishtina, pasardhësi i familjes së heroit Hasan Prishtina, i shoqëruar nga Skender Asani dhe Hysen Berisha. Në shenjë falënderimi për punën dhe misionin e kësaj agjencie, drejtorit të saj Ylber Sela ia dhuroi një fotografi me portretin e figurës së Hasan Prishtinës.



Me këtë rast drejtori Sela e njoftoi mikun Mehmet Prishtina me punën e deritashme të AZGJ-së dhe pengesat e ndryshme që shfaqen gjatë zbatimit të gjuhës në institucionet shtetërore.

Mehmet Prishtina e përgëzoi drejtorin Sela për punën e bërë duke i uruar të vazhdojë me po të njëjtin seriozitet dhe profesionalizëm.

3 mars 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela e vizitoi Qendrën Nacionale të Konservimit

Sot, drejtori i AZGJ-së Ylber Sela takoi drejtorin e Qendrës Nacionale të Konservimit, Memet Selmanin për të parë nga afër se deri ku ka arritur kjo qendër me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Gjatë këtij takimi, drejtori Selmani foli për sfidat me të cilat ballafaqohet kjo qendër, në radhë të parë me detyrat e saj, siç është rikonstruimi i objekteve të trashëgimisë kulturore e fetare. Sa i përket zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, Selmani theksoi se deri tani është bërë mjaft, por shtoi se nevojitet edhe shumë punë deri në zbatimin e plotë të tij.

Me këtë rast, drejtori Sela i ofroi ndihmë dhe përkrahje institucionale homologut të tij për realizimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

9 mars 2020

Fjalim përshëndetës i drejtorit Sela me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit

Me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, në hapësirat e veta mbajti tribunën shkencore me temë: "Gjendja e arsimit në vend, sfidat dhe perspektivat", ku me pjesëmarrjen e dhjetëra studiuesve dhe punonjësve arsimorë u diskutua dhe u dhanë mendime, si dhe ide frytdhënëse për temën në fjalë.

Pas hapjes së tribunës nga organizatorja dhe punonjësja e këtij instituti, si dhe rezymesë së shkurtër të arsimit shqip, rolit të shkollave shqipe dhe

arsimtarëve me misionin të tyre ndër shekuj, fjalë përshëndetëse pati drejtori i këtij instituti, z. Skender Asani, i cili foli për aspektin historik të kësaj ngjarjeje të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare.





Po ashtu, fjalë përshëndetëse pati edhe këshilltari shtetëror i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, z. Safet Neziri, i cili të pranishmëve ua përcolli përshëndetjet e ministrit të Arsimit, Arbër Ademit.

Manifestimin e përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, z. Ylber Sela, ku në mes të tjerash tha se festa e 7 Marsit është një traditë e bukur e krijuar te populli ynë. Në këtë ditë të rëndësishme të arsimit shqiptar, kujtojmë me respekt të veçantë veprën e çmuar të mësuesve, arsimdashësve dhe atdhetarëve të shquar, që punuan me përkushtim dhe bënë sakrifica të mëdha për zhvillimin e arsimit kombëtar në Maqedoninë e Veriut.

Pas fjalës përshëndetëse të kryetarit të Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë, z. Nuhi Dardhishta, dhjetëra studiues, pjesëmarrës në këtë tribunë shkencore, trajtuan aspektin shkencor, ligjor dhe historik të sfidave dhe avancimit të arsimit shqip, si: Abdyrauf Pruthi, Hasan Jashari, Ajten Hajdari Qamili, Avni Avdiu, Tahir Zajazi, Minir Ademi, Xheladin Murati, Lulzim Mehmedi etj.

23 qershor 2020
Bashkëpunimi mes AZGJ-së dhe misionit të OSBE-së

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune nëpërmjet videokonferencës me Katarina Zhivkoviqin, ndihmëse e lartë programi në Misionin e OSBE-së në Shkup. Takimi ishte një mundësi e mirë për të vazhduar dialogun midis AZGJ-së dhe OSBE-së për tema me interes të përbashkët.



Përfaqësuesja e OSBE-së e informoi se edhe përkundër situatës së krijuar nga pandemia e virusit korona COVID-19, Misioni i OSBE-së do t'i shtojë aktivitetet për të siguruar ndihmë në nivel ekspertësh për përgatitjen e një dokumenti strategjik shumëvjeçar për punën e AZGJ-së. Njëkohësisht, Misioni i OSBE-së do të sigurojë edhe një numër botimesh që do të dhurohen për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së.

Drejtori Sela shprehu falënderim për mbështetjen e deritanishme dhe theksoi se bashkëpunimi dhe dialogu me OSBE-në kanë rëndësi të veçantë. AZGJ-ja do të vazhdojë të jetë partner konstruktiv i OSBE-së në zbatimin e aktiviteteve projektuese që synojnë respektimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve dhe promovimin e vlerave demokratike europiane, theksoi drejtori Sela.

27 qershor 2020

Drejtori Ylber Sela foli në zbulimin e pllakës përkujtimore në gjuhën shqipe në shtëpinë e Nënë Terezës

Sot në sheshin e Shkupit, pikërisht në vendin ku dikur ndodhej shtëpia e lindjes e Nënë Terezës, u shënua 40-vjetori i shpalljes së saj si qytetare nderi e qytetit. Me këtë rast aty u shpalos edhe pllaka përkujtimore në gjuhën shqipe.





Në këtë aktivitet, para të pranishmëve foli drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH), Skënder Asani, i cili në mes të tjerash theksoi se tani e tutje gjuha e Nënë Terezës do të shënohet bashkë me gjuhët e tjera në pllakën përkujtimore të saj, me çka do ta plotësojë mozaikun shumetnik dhe shumëgjuhësor.

Po ashtu, të pranishmit i përshëndeti edhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës i RMV-së, Arbër Ademi, me ç'rast drejtorit të ITSHKSH-së, Skënder Asani, ia dorëzoi aktin e regjistrimit të Regjistrit Qendror të Departamentit të studimit të jetës dhe veprës së Nënë Terezës në kuadër të institutit në fjalë.

Krahas këtyre, pjesëmarrësit i përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, i cili theksoi se prej sot pllaka përkujtimore, e cila shënon vendin ku lindi Nënë Tereza, është edhe në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë kjo gjuhë do të qëndrojë e barabartë pranë gjuhëve të tjera. Natyrisht ky akt përkon edhe me zbatimin zyrtar të gjuhës shqipe, punë kjo të cilën tanimë e kryen me sukses AZGJ-ja.

30 qershor 2020
Ambasadorja e Ukrainës e vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës



Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, priti një delegacion të udhëhequr nga Natalia Zadorozhnjuk, ambasadore e Ukrainës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe Roman Bugën, sekretar i parë dhe zëvendësambasador.

Vizita në AZGJ u bë me ftesë të drejtorit Sela, i cili bashkëbiseduesit i falënderoi për vizitën, ndërkaq njëkohësisht i informoi ata për punën dhe funksionimin e AZGJ-së, si subjekt i rëndësishëm institucional në mbështetje të përpjekjeve të Qeverisë për të ndërtuar një ambient, që do të respektojë, mbrojë dhe promovojë të drejtat e qytetarëve të saj, përfshirë këtu edhe të drejtën për të shprehur dhe përdorur gjuhën e tyre amtare. Drejtori Sela u dhuroi të ftuarve nga një kopje të botimeve të përgatitura nga AZGJ-ja, si dhe i njoftoi me kapacitetet hapësinore, teknike dhe personelin që disponon AZGJ-ja.



Ambasadorja Zadorozhnjuk e falënderoi drejtorin Sela për ftesën për të vizituar Agjencinë, duke theksuar se Ambasada e Ukrainës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbështet dhe njeh rolin e rëndësishëm të AZGJ-së, si dhe shprehu gatishmërinë për dialog, ku po ashtu u shkëmbyen mendime për zbatimin e politikave gjuhësore dhe planin e punës në AZGJ për periudhën në vijim.

Të dyja palët diskutuan edhe për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë, nëpërmjet pjesëmarrjes në ngjarje të organizuara nga të dyja palët, shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e një udhëtimi studimor në Ukrainë.

2 korrik 2020

Biblioteka e AZGJ-së u pasurua edhe me disa fjalorë terminologjikë

Këto ditë Agjencia e Zbatimit të Gjuhës arriti t'i sigurojë edhe disa fjalorë të rrallë për nevojat e saj, të cilët janë botuar para shumë vitesh dhe që shumë vështirë mund të gjenden në shitje. Kështu, krahas shumë fjalorëve të tjerë, tani e tutje në bibliotekën e saj do të jenë edhe këta: Fjalor terminologjik serbokroatisht – shqip (autorë Sh. Veliu, S. Drini, A. Zaimi – botuar në vitin 1961); "Fjalor maqedonisht – shqip (autorë Mile Qorvezirovski dhe Lutfi Rusi, i botuar në vitin 1967); Fjalor i terminologjisë tekniko shkencore – shqip, serbokroatisht, rusisht, frëngjisht (përgatitur nga grup autorësh, botuar në vitin 1967), Fjalor i mikrobiologjisë (botuar në vitin 1980); Fjalor i termave të ekonomisë politike – shqip, frëngjisht, rusisht (botuar më 1983); Fjalor i terminologjisë së biznesit anglisht – shqip dhe shqip – anglisht (autor Nexhmi Rexha, botuar më 2001), Fjalor i termave themelore të bujqësisë shqip, anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht (hartuar nga grup autorësh, botuar më 2006); Fjalori katërgjuhës i Danil Voskopojarit).



Natyrisht këta fjalorë do t'ua lehtësojnë punën dhe dilemat me të cilat ballafaqohen përkthyesit dhe lektorët e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës.

20 korrik 2020

AZGJ-ja i përktheu formularët e MPB-së në gjuhën shqipe

Pas një pune të palodhur, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës arriti që t'i përkthejë në gjuhën shqipe dhe t'i lekturojë një numër të madh formularësh të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Sektori i çështjeve civile.

Natyrisht kjo erdhi si rezultat i bashkëpunimit të frytshëm të këtyre dy institucioneve, pas një takimi që pati drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, me ndihmësministrin e MPB-së, Xhevdet Azizi. Si rezultat i kësaj, tani e tutje qytetarët shqiptarë për nevojat e tyre do të kenë mundësi që formularët t'i plotësojnë edhe në gjuhën shqipe.



Sigurisht ky angazhim i AZGJ-së do të vazhdojë edhe më tej për t'i përmbushur detyrimet e saj, duke i ndihmuar institucionet e tjera. Prandaj i inkurajon ato që t'i drejtohen AZGJ-së dhe të kërkojnë ndihmë.

20 korrik 2020

Rasti i Ajet Rexhepit–shembull i ndritshëm në përpjekjet për mosdiskriminimin gjuhësor

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi takim pune me Ajet Rexhepin, këshilltar për ekonomi vendore në komunën e Gazi Babës.



Drejtori Sela shprehu mirënjohjen për vizitën dhe theksoi se kjo paraqet kënaqësi të veçantë që është nikoqir i z. Rexhepit, si një njeri që simbolizon guximin, integritetin dhe këmbënguljen në realizimin e të drejtës së tij gjuhësore qytetare në mjedisin ku ai punon. Pas disa vitesh beteje gjyqësore, rasti i z. Rexhepit mori epilog pozitiv, ku në rastin e tij, si nga Gjykata e Shkallës së Parë, ashtu edhe nga Gjykata e Apelit, u vërtetua shkelje e të drejtës së trajtimit të barabartë, përkatësisht diskriminim i vërtetuar në bazë gjuhësore dhe përkatësie etnike në sferën e punës dhe të marrëdhënieve të punës.



Të dy palët u pajtuan se një epilog i këtillë gjyqësor është shembull që do të ndikojë pozitivisht, jo vetëm në zbatimin e praktikës gjyqësore edhe në raste të tjera të ardhshme të këtij karakteri, por edhe në parandalimin, afirmimin dhe përparimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit në aspektin e mbështetjes së angazhimeve qeveritare për ndërtimin e një mjedisi shoqëror që i respekton, mbron dhe përparon të drejtat gjuhësore të qytetarëve. Gjuha shqipe është gjuhë zyrtare dhe garantohet me ligj dhe çdokush që në të ardhmen do të diskriminohet në bazë gjuhësore duhet të ankohet në institucionet përkatëse.

22 korrik 2020

Prof. dr. Ali Pajaziti ia dhuroi fjalorët e tij bibliotekës së AZGJ-së

Dje, Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) e vizitoi sociologu dhe profesori universitar Ali Pajaziti, i cili u prit nga drejtori Ylber Sela.

Me këtë rast profesor Pajaziti ia dhuroi ca kopje të fjalorëve të tij bibliotekës së agjencisë.



Gjatë këtij takimi, në mes të tjerash, drejtori Sela dhe profesor Ali Pajaziti e shfrytëzuan rastin që të bashkëbisedojnë më hollësisht rreth projekteve që janë paraparë për vitin 2020, por njëkohësisht edhe për format e bashkëpunimit në të ardhmen.

27 korrik 2020

Drejtori Sela realizoi takim me albanologun Ismail Hamiti

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, priti sot në një takim albanologun Ismail Hamiti, pasi këtyre ditëve ai botoi librin me titull “Bazat e përkthimit dhe të interpretimit”, si rezultat i punës së tij gati njëzetvjeçare në lëmin e përkthimit e që

kap segmentin e mësimit të gjuhës shqipe nga të huajt, fushën e përkthimit, të redaktimit gjuhësor dhe menaxhimit të drejtpërdrejtë me Sektorin e përkthimit në Kuvendin e RMV-së.





Libri në fjalë synon t'ju japë njohuri elementare për çështjet teorike dhe praktike të përkthimit dhe interpretimit të gjithë atyre që dëshirojnë të merren me përkthim dhe interpretim; atyre që tani më e praktikojnë këtë profesion; që menaxhojnë me përkthyes dhe interpretues, si dhe atyre që nuk merren me të, por që janë kureshtarë të dinë më shumë për profesionin e përkthyesit dhe të interpretuesit.

Mbi të gjitha, urojmë që ky libër do t'ju vijë në ndihmë personave që merren me përkthim dhe interpretim, pa marrë parasysh kombinimin e gjuhëve të cilat i përdor dhe se do të inkurajojë edhe studiues të tjerë të merren me këtë fushë.
Me këtë rast albanologu Hamiti, me disa ekzemplarë nga libri më i ri i tij e pasuroi edhe bibliotekën e Agjencisë.

27 korrik 2020

EURAC vazhdon bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me AZGJ-në



Një nga qendrat më të shquara europiane të kërkimit EURAC, me seli në Bolzano të Italisë, vazhdon të mbështesë Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Krahas vizitave të përfaqësuesve të AZGJ-së në EURAC dhjetorin e kaluar, si dhe vizitën e përfaqësuesve të EURAC në Shkup, në shkurt të 2020, si pjesëmarrës në Konferencën Shkencore të organizuar nga AZGJ-ja; këto ditë EURAC siguroi edhe disa tituj librash për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së, e cila tashmë, posedon një numër të madh librash, fjalorësh terminologjikë, revista profesionale, etj.

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, shpreh falënderimin e tij ndaj qendrës EURAC për mbështetjen e dhënë, duke siguruar që bashkëpunimi midis dy palëve do të vazhdojë të zhvillohet dhe përparojë me intensitet dhe dinamikë edhe më të madhe.


19 gusht 2020

AZGJ-ja e promovoi Doracakun e nëpunësve administrative për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup u promovua Doracaku i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Para të pranishmëve foli drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili theksoi se qëllimi i këtij doracaku është që t'i orientojë dhe t'jua lehtësojë punën nëpunësve administrativë në institucionet shtetërore.

Në vazhdim foli edhe Ajten Hajdari Qamili, njëra nga përpilueset e doracakut, e cila u ndal në udhëzimet praktike se si duhet të shkruhen shkresat zyrtare. Disa fjalë i tha edhe profesori Bashkim Selmani, po ashtu njëri nga

përpiluesit e doracakut, duke theksuar se tani gjuha shqipe e ka një adresë institucionale, e kjo është AZGJ-ja, e cila ka përgatitur këtë doracak.



Ky doracak është hartuar kryekëput duke u mbështetur në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, ku përcaktohet qartë se cilat janë gjuhët zyrtare në RMV,

cila është e drejta individuale e nëpunësve për të komunikuar me anë të tyre, cilat janë detyrimet që duhet t'i kryejnë ata etj. Brenda tij janë dhënë edhe të gjitha format e nevojshme që u nevojiten atyre në rrafshin e komunikimit administrativ: si shkruhet një lutje, një kërkesë, një njoftim, një procesverbal, një ftesë, një kontratë, një ankesë etj.



Në përpilimin e këtij doracaku kanë marrë pjesë gjuhëtarë, mësimdhënës, punonjës shkencorë nga vendi dhe nga jashtë, duke shpresuar se nëpunësve administrativë do t'ju bëhet ndihmës kryesor në punën e përditshme të tyre.

20 gusht 2020

Jusuf Zejneli dhe Argëtim Saliu i dhuruan AZGJ-së disa kopje të librit "E drejta dhe administrata publike"



Profesorët universitarë dhe autorët e librit "E drejta dhe administrata publike", prof. dr. Jusuf Zejneli dhe doc. dr. Argëtim Saliu, e vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës dhe u pritën nga drejtori i këtij institucioni, Ylber Sela, i cili njëherësh i njoftoi edhe me aktivitetet dhe projektet që i realizon AZGJ-ja.



Me këtë rast ata i dhuruan bibliotekës së AZGJ-së disa kopje të librit të tyre "E drejta dhe administrata publike".

10 shtator 2020

AZGJ-ja filloi me shpërndarjen e fletushkës për të drejtat gjuhësore

Nëpunësit administrativë të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) prej sot filluan shpërndarjen e fletushkës për të drejtat themelore gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme.
Qëllimi i publikimit dhe i shpërndarjes së kësaj fletushke është që qytetarët të njihen me të drejtat e tyre themelore gjuhësore. Kjo përmban informacione të mjaftueshme e të sakta, si dhe sqarohet se ku mund qytetarët ta përdorin gjuhën amtare në institucionet shtetërore.



Po ashtu, qytetarëve u bëhet me dije se në çdo institucion publik apo komunal, ku më së paku 20% e qytetarëve e flasin gjuhën amtare, kanë të drejtë ligjore që ta përdorin atë dhe të drejtohen zyrtarisht.



Në këtë mënyrë AZGJ-ja po e afirmon dhe promovon këtë të drejtë themelore nëpërmjet fletushkave, doracakëve ose udhëzuesve të ndryshëm që i ka botuar deri tani.

11 shtator 2020

AZGJ-ja edhe në Tetovë shpërndau fletushka për të drejtat gjuhësore

Nëpunësit administrativë të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) sot në Tetovë shpërndanë fletushkën për të drejtat themelore gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.





Qëllimi i publikimit dhe i shpërndarjes së kësaj fletushke është që qytetarët të njihen me të drejtat e tyre themelore gjuhësore. Kjo përmban informacione të mjaftueshme e të sakta, si dhe sqarohet se ku mund qytetarët ta përdorin gjuhën amtare në institucionet shtetërore.

11 shtator 2020

Takim pune i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela me përfaqësuesit e fakulteteve filologjike

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, me këshilltaren e tij të jashtme, dr. Ajten Hajdari Qamili dhe drejtuesin e Sektorit të përkthimit dhe lekturimit, Ahmet Selmani, zhvilluan një takim pune me dr. Berton Sulejmanin, dekan i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tetovës, dr. Demush Bajrami, profesor në Universitetin e Europës Juglindore, dr. Mustafa Ibrahimi, profesor në Universitetin "Nënë Tereza" dhe dr. Ismet Osmani, profesor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi".




Me këtë rast drejtori Y. Sela i informoi përfaqësuesit në fjalë lidhur me aktivitetet që ka ndërmarrë AZGJ-ja për shënimin e Ditës Europiane të Gjuhëve, më 26 shtator 2020 dhe Ditës së Përkthimit më 30 shtator 2020. Në vazhdim ai foli edhe për planet dhe bashkëpunimin e AZGJ-së me këto fakultete si një mundësi e mirë për të organizuar aktivitete të përbashkëta për shumë çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të gjitha këto ide dhe oferta të tij u përkrahën njëzëri nga të pranishmit, duke dhënë edhe mendime dhe propozime të tjera plotësuese për sa i përket hartimit të fjalorëve të ndryshëm terminologjikë, trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve për nevojat e institucioneve, organizimit të punëtorive me studentët, organizimit të konferencave shkencore etj.

12 shtator 2020

Të punësuarit e AZGJ-së e vizituan Panairin e Librit

Në mënyrë të organizuar, të punësuarit e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës e vizituan Panairin e Librit në Shkup. Ky panair u hap më 8 shtator dhe do të mbyllet më 14 shtator. Në stendat e tij, të cilat janë vendosur nën tenda, përballë A1 Arenës "Boris Trajkovski" në Shkup, janë ekspozuar mijëra libra, në mesin e tyre gjenden edhe mjaft botime në gjuhën shqipe. Gjatë kësaj vizite, të punësuarit e AZGJ-së u interesuan dhe blenë një numër librash e fjalorësh.




16 shtator 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela realizoi takim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës

Sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela takoi ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës (MSHIA), Jeton Shaqiri. Në këtë takim ia uroi detyrën e re, si dhe e informoi lidhur me aktivitetet që po i zhvillon kjo agjenci në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Po ashtu, drejtori Sela foli edhe për detyrimet që





kanë institucionet shtetërore në zbatimin e këtij ligji. Njëkohësisht ai shprehu gatishmëri për t'i dhënë mbështetje edhe Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës për sa i përket përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve dhe shkresave zyrtare.

Edhe ministri Shaqiri foli për këto çështje duke falënderuar drejtorin Sela për gatishmërinë dhe mbështetjen e ofruar, si dhe duke u zotuar se do të angazhohet seriozisht në aspektin e përdorimit të gjuhës shqipe në këtë institucion.

18 shtator 2020

Në Kërçovë dhe Kumanovë AZGJ-ja shpërndau broshura për të drejtat gjuhësore

Nëpunësit administrativë të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) dje dhe sot në Kërçovë dhe Kumanovë shpërndanë broshurën për të drejtat themelore gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Qëllimi i publikimit dhe i shpërndarjes së kësaj broshure është që qytetarët të njihen me të drejtat e tyre themelore gjuhësore. Kjo përmban informacione të mjaftueshme e të sakta, si dhe sqarohet se ku mund qytetarët ta përdorin gjuhën amtare në institucionet shtetërore.



21 shtator 2020

Drejtori Sela i ofroi mbështetje Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela vizitoi Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor (MMJPH) ku edhe pati takim pune me ministrin Naser Nuredini.

Në takim palët diskutuan për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve, si dhe për shkallën e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në punën e ministrisë.



Me këtë rast, ministri Nuredini e informoi drejtorin Sela rreth gjendjes me kuadrin dhe gatishmërisë teknike të ministrisë në lidhje me harmonizimin e proceseve të punës me dispozitat ligjore. Nga ana tjetër, drejtori Sela ofroi zgjidhje për tejkalimin e disa kushteve të caktuara, si dhe ndihmë profesionale në pjesën e përkthimit dhe lekturimit të formularëve zyrtarë për nevojat e ministrisë.

Të dy palët e konstatuan nevojën e përparimit dhe të përshpejtimit të përpjekjeve për zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave ligjore lidhur me përdorimin e gjuhëve dhe shprehën gatishmëri për vazhdimin dhe përparimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

23 shtator 2020

BNU "Shën Klementi i Ohrit" i dhuroi AZGJ-së disa botime

Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet AZGJ-së dhe BNU "Shën Klementi i Ohrit"- Shkup, sot u bë pranim-dorëzimi i botimeve për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së, për të cilat BNU "Shën Klementi i Ohrit" dha pëlqimin për t'ia dhuruar.



Përzgjedhja e botimeve përfshin kryesisht fjalorë terminologjikë, botime që kanë të bëjnë me filologjinë shqiptare, por edhe botime me tema kulturore.

Me këtë rast, drejtori i AZGJ-së Ylber Sela, shprehu mirënjohje për Bibliotekën Nacionale Universitare "Shën Klementi i Ohrit" – Shkup dhe drejtorin e saj Frymëzim Dauti, për botimet e dhuruara, gjithashtu duke shpresuar se bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të vazhdojë të përmirësohet në të ardhmen.

25 shtator 2020

Në Dibër dhe në Strugë, AZGJ-ja shpërndau broshura për të drejtat gjuhësore



Nëpunësit administrativë të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), dje dhe sot në Dibër dhe Strugë shpërndanë broshurën për të drejtat themelore gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Qëllimi i publikimit dhe i shpërndarjes së kësaj broshure është që qytetarët të njihen me të drejtat e tyre themelore gjuhësore. Kjo përmban informacione të mjaftueshme e të sakta, si dhe sqarohet se ku mund qytetarët ta përdorin gjuhën amtare në institucionet shtetërore.

25 shtator 2020

Biblioteka e AZGJ-së u pasurua me Fjalorin e Termave në Arsim

Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës e vizituan autorët e Fjalorit të Termave në Arsim, shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip, mr. Ardiana Isahi Palloshi dhe mr. Ridvan Zeqiri, të cilët i priti drejtori Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij. Në takim ai i informoi lidhur me aktivitetet dhe projektet e institucionit që e udhëheq. Gjatë këtij takimi biseduan edhe për shumë çështje që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, sidomos me terminologjinë në përgjithësi.





Më këtë rast autorët në fjalë i dhuruan disa kopje të këtij fjalori për bibliotekën e AZGJ-së. Kështu, mozaikut të gjerë të fjalorëve për nevojat e përkthyesve dhe lektorëve iu shtua edhe ky fjalor i veçantë.

26 shtator 2020

AZGJ-ja e shënoi Ditën Europiane të Gjuhëve

Me rastin e 26 Shtatorit – Ditës Europiane të Gjuhëve, AZGJ-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët në Klubin e Deputetëve me temë "Shumëgjuhësia në Republikën e Maqedonisë së Veriut – një mundësi ose pengesë në procesin e ndërtimit të një shoqërie qytetare demokratike".

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, iu drejtua të pranishmëve dhe përfaqësuesve të medieve, duke theksuar se AZGJ-ja njeh rëndësinë e kësaj date simbolike që

shënon shumëgjuhësinë dhe diversitetin gjuhësor në Europë. AZGJ-ja do të vazhdojë ta shënojë këtë datë të rëndësishme, sepse shkalla e respektit dhe edukimit të larmisë gjuhësore është pasqyrim i shkallës së zhvillimit demokratik të secilit shtet.

Në tryezën e rrumbullakët, paraqitje kishin edhe Xhelal Hoxhiq, zëvendësdrejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive; Ana Popova Manasievska, kryetare e Shoqatës së Përkthyesve dhe të Interpretuesve (MATA); Diana Treneska, përfaqësuese nacionale e Këshillit të Europës për shënimin e Ditës Europiane të Gjuhëve dhe përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës; Dragana Gjoreska, profesoreshë në SHEJQSH "Vasil Antevski–Dren", si dhe profesoresha universitare Ajten Hajdari Qamili.















26 shtator 2020

Fjalimi i plotë i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në tryezën e rrumbullakët me temë: "Shumëgjuhësia në Republikën e Maqedonisë së Veriut – mundësi apo pengesë në procesin e ndërtimit të shoqërisë qytetare demokratike", organizuar me rastin e shënimit të Ditës Europiane të gjuhëve"



"I nderuar drejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Komuniteteve, zotëri Hoxhiq,
e nderuara kryetare e Shoqatës së Përkthyesve dhe Interpretuesve, zonja Popova Manasievska,
e nderuara përfaqësuese nacionale e Këshillit të Europës për shënimin e Ditës Europiane të Gjuhëve dhe përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, zonja Treneska,
e nderuar profesoreshë Gjoreska,
të nderuar përfaqësues të medieve!
të nderuar të pranishëm!

Kam nderin dhe kënaqësinë që së bashku kemi rastin ta shënojmë ngjarjen e sotme, e cila ka rëndësi të veçantë dhe mbahet më 26 shtator, në ditën kur Europa feston shumëgjuhësinë, respektivisht Ditën Europiane të Gjuhëve.

Këtë ditë simbolike e shënon edhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së nëpërmjet organizimit të tryezës së sotme të rrumbullakët me një temë shumë të rëndësishme që lidhet me shumëgjuhësinë në një shoqëri demokratike qytetare.

Filozofi i shquar Ludvig Vitgenshtajn ka thënë: "Nuk guxojmë të lejojmë që kufijtë e gjuhës sonë të jenë kufij të botës sonë". Kjo thënie e urtë na kujton se vlerat e pluralitetit gjuhësor dhe roli i tij koheziv i ndërlidhjes së dallimeve, vazhdimisht duhet të riafirmohen dhe të kultivohen. Në vend se të jetë mjet për ndarje, gjuha duhet të jetë kanal komunikimi, urë lidhëse dhe mjet interaksioni në komunitetin shoqëror.

Shkalla e respektimit dhe e kultivimit të diversitetit gjuhësor është reflektim i shkallës së zhvillimit demokratik të çdo shteti që synon të jetë pjesë e familjes europiane të shteteve me traditë të pasur demokratike.

Besoj që prania e gjithë pjesëmarrësve në ngjarjen e sotme do të mundësojë shkëmbim konstruktiv të ideve, qëndrimeve dhe mendimeve dhe se pjesëmarrësit do ta pasurojnë këtë ngjarje me fjalimet e tyre në drejtim të afirmimit të vlerave që e përforcojnë dhe e avancojnë barazinë gjuhësore, kuptimin e ndërsjellë dhe kohezionin ndëretnik në shoqëri nëpërmjet dialogut, tolerancës gjuhësore dhe respektimit të diversitetit gjuhësor.

Më lejoni që, në fund të fjalimit, edhe njëherë t'ju falënderoj të gjithë folësve dhe mysafirëve të nderuar për pjesëmarrjen në tryezën e sotme".

28 shtator 2020

Vazhdon dialogu i AZGJ-së me delegacionin e UE-së

Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) priti Aleksandru Andrej Popoviçin, zyrtar i kualifikuar i të drejtave të njeriut, shoqërisë civile dhe i marrëdhënieve ndërmjet bashkësive në delegacionin e Bashkimit Europian në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë takim, drejtori Sela falënderoi bashkëbiseduesin e tij për vizitën, duke e informuar atë për punën e AZGJ-së në mbështetje të përpjekjeve të qeverisë për të ndërtuar një shoqëri që garanton, respekton dhe promovon të drejtat gjuhësore të qytetarëve të saj, në përputhje me standardet europiane.

Gjithashtu, drejtori Sela informoi bashkëbiseduesin e tij për punën e bërë deri më tani, projektet e planifikuara në të ardhmen, dhe shprehu gatishmërinë për të rritur bashkëpunimin me delegacionin e BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ambasadorin e ri, Dejvid Gir.



Popoviçi falënderoi drejtorin Sela për ftesën për një takim dhe vizitë në AZGJ, duke shprehur kënaqësi për mundësinë e dhënë për shkëmbim të drejtpërdrejtë të pikëpamjeve rreth çështjeve të interesit të përbashkët.

Të dy palët theksuan angazhimin e tyre për dialog të mëtejshëm dhe bashkëpunim në projekte.


30 shtator 2020

AZGJ-ja e shënoi Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës sot zhvilloi një aktivitet të veçantë kushtuar kësaj date. Kjo ngjarje kishte të bëjë me promovimin e dy librave, përkatësisht "Shkrime rreth përkthimit" të Xhevat Lloshit dhe "Bazat e përkthimit dhe të interpretimit" të Ismail Hamitit.

Fjalë rasti për librin e Xhevat Lloshit, të cilin e botoi AZGJ-ja, mbajti profesoresha Ajten Hajdari Qamili e cila foli për përmbajtjen dhe vlerat e veçanta të tij. Po ashtu, ajo foli edhe për librin e Ismail Hamitit duke u përqëndruar në strukturën dhe rëndësinë e këtij libri që trajton çështjen e përkthimit dhe të interpretimit.

Në vazhdim, për librin e Xhevat Lloshi foli edhe referuesi Naim Berisha nga Instituti Albanologjik i Prishtinës i cili e vuri në spikamë personalitetin e gjuhëtarit Xhevat Lloshi, dhe njëkohësisht duke i theksuar edhe disa aspekte që e karakterizojnë librin e tij.






Fjalë rasti pati edhe Hidajete Azizi nga ITSHKSH-ja, e cila vuri në dukje aspektet e rëndësishme të dy librave, përkatësisht atë të Xhevat Lloshit dhe të Ismail Hamitit.

Gjithashtu në këtë promovim foli edhe referuesi Berton Sulejmani, dekan i Fakultetit të Filologjisë në UT, i cili theksoi vlerat shkencore të librit “Shkrime rreth përkthimit” të Xh. Lloshit.

Në fund, nëpërmjet lidhjes onllajn, në këtë ngjarje u përfshi edhe Xhevat Lloshi i cili e falënderoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës për botimin e librit të tij, si

dhe për organizimin e këtij promovimi. Në mes të tjerash ai theksoi se librin e tij ia besoi pikërisht AZGJ-së për botim për arsye të respektit dhe solidaritetit që ka ndaj këtij institucioni që po bën një punë jashtëzakonisht serioze për gjuhën shqipe.

Të pranishmëve iu drejtua edhe Ismail Hamiti, i cili i falënderoi të gjithë ata që dhanë ndihmesë në botimin e librit të tij, veçanërisht AZGJ-në e cila bëri promovimin e tij.

13 tetor 2020

Takim i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela me kreun e BFI-së

Sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, Ylber Sela e vizitoi Bashkësinë Fetare Islame, ku u mirëprit nga kreu i saj Reis-ul Ulema Shaqir Fetahu. Takimi i dy titullarëve kishte për qëllim shkëmbimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të përbashkëta, në lidhje me zbatimin e gjuhës shqipe si brenda institucioneve, ashtu dhe në jetën publike.




Drejtori i AZGJ-së, Sela pasi ia uroi zotëri Shaqir Fetahut postin e reisit në këtë institucion të lartë që e udhëheq jetën shpirtërore të qytetarëve të besimit islam, me këtë rast ia dhuroi disa botime të AZGJ-së që shërbejnë si informacione të dobishme në zbatimin e gjuhës shqipe: "Udhëzuesin për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve", si dhe botimin e fundit "Doracaku për nëpunësit administrativë".

Të dy titullarët u pajtuan se zbatimi i gjuhës shqipe është një çështje e rëndësishme që u përket të gjithë qytetarëve. Përveç të tjerash, ata shprehën pikëpamjet e sinqerta dhe vullnetin e mirë që bashkëpunimi midis AZGJ-së dhe BFI-së, duhet të zhvillohet në mënyrë më cilësore në aspektin e kultivimit dhe të artikulimit të gjuhës shqipe në të gjitha segmentet e shoqërisë sonë.

19 tetor 2020

Donacion i fjalorëve nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë



Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhuroi fjalorë me terminologjinë ushtarake për nevojat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, për të cilën kjo është falënderuese ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe veçanërisht ndaj zëvendësministrit Petro Koçi.

21 tetor 2020

Ditët e hapura të Institutit të Gjuhës Maqedonase "Kërste Misirkov"



Në kuadër të Ditëve të Hapura të Institutit të Gjuhës Maqedonase "Kërste Misirkov", nga 19-22 tetor 2020, u mbajt konferencë ndërkombëtare shkencore, në të cilën u paraqit me punimin e saj shkencor përfaqësuesja e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, dr. Liljana Pandeva.

22 tetor 2020

Vizita e drejtorit Sela në OEMVP

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, e vizitoi Dhomën Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP), ku pati një takim pune me Drilon Isenin, drejtor ekzekutiv i OEMVP-së.

Gjatë takimit, drejtori Sela theksoi se AZGJ-ja është gjithmonë e hapur për bashkëpunim, përfshirë edhe me OEMVP-në, si një trup që organizon, mbron interesat dhe promovon afarizmin në vend dhe jashtë, duke i mbështetur ato në sfidat e konkurrencës globale.



Takimi ishte një mundësi për të marrë informacion në lidhje me situatën aktuale me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në punën e OEMVP-së. Në të njëjtën kohë, drejtori Sela u interesua për mundësinë që konsumatorët, çmimet dhe deklaratat për përdorimin e mallrave të shkruhen në gjuhët zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Të dyja palët shprehën gatishmëri për të vazhduar dhe forcuar më tej bashkëpunimin dypalësh.

24 tetor 2020

Informacione për të drejtat e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për përdorimin e gjuhëve




Ekipi i AZGJ-së bëri prezantimin me karakter informativ lidhur me të drejtat e qytetarëve për përdorimin e gjuhëve në procedurat e institucioneve publike

27 tetor 2020

AZGJ-ja filloi bashkëpunimin me Agjencinë e Shërbimeve Mediatike, Audio dhe Audiovizuale

Sot përfaqësuesit e AZGJ-së realizuan një takim pune me përfaqësuesit e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike, Audio dhe Audiovizuale, Andriana Skerlev-Çakar, udhëheqëse e Sektorit të çështjeve juridike; Ivona Mufisheva Aleksovska, udhëheqëse e Njësisë së çështjeve normative-juridike dhe Kalina Stojanovska, bashkëpunëtore e çështjeve juridike dhe burimeve njerëzore në Njësinë e çështjeve administrativo-juridike.




Gjatë këtij takimi u diskutua për shkallën e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike, Audio dhe Audiovizuale, përshtatjet dhe hapat e nevojshme që duhet të ndërmerren, duke sqaruar edhe dilema të caktuara lidhur me zbatimin praktik të saj.

Të dyja palët shprehën gatishmëri për bashkëpunimin dhe përforcimin e dialogut të ndërsjellë, në mënyrë që të zbatohet me sukses dhe në mënyrë të vazhdueshme Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

31 tetor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela e vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, bashkë me përgjegjësin e Sektorit të përkthimit dhe të lekturimit në këtë institucion, Ahmet Selmani, dje zhvilloi një takim zyrtar në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku u prit nga kryetari i saj, akademiku Mehmet Kraja, si dhe akademiku i mirënjohur Rexhep Ismajli.

Gjatë takimit në fjalë, drejtori Y. Sela i njoftoi hollësisht nikoqirët për statusin, rolin dhe punën e AZGJ-së, duke u përqendruar veçmas në aktivitetet e gjertanishme në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, si dhe në atë të sensibilizimit dhe udhëzimit të qytetarëve lidhur me të drejtat gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Po ashtu, ai shprehu interesim

dhe u bëri ftesë pjesëtarëve të ASHAK-së për të marrë pjesë në aktivitetet shkencore që i organizon AZGJ-ja në raste të ndryshme, siç është Dita e Përkthimit dhe Dita Europiane e Gjuhëve.





Kryeakademiku Mehmet Kraja, duke u falënderuar për këtë vizitë zyrtare të AZGJ-së, u interesua në veçanti për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve dhe zbatimin e tij praktik në RMV, për kontaktet e AZGJ-së me institucionet simotra në vendet e tjera, si dhe për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me këtë institucion. Me këtë rast ai shprehu gatishmëri për të ndihmuar ose për të qenë të pranishëm në aktivitetet e AZGJ-së, duke kërkuar një ofertë konkrete se çfarë mund të bëjë ASHAK-ja në këtë aspekt.

Po ashtu, edhe akademiku Rexhep Ismajli shprehu gatishmëri të plotë për të ndihmuar AZGJ-në nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në konferencat shkencore. Ai foli për pozitën e disa gjuhëve në vende të ndryshme të botës si në Spanjë, Belgjikë, Zvicër etj., duke e theksuar statusin dhe trajtimin e tyre nga shtetet përkatëse, me çka modeli i tyre do të ishte i lakmueshëm dhe i natyrshëm edhe për gjuhën shqipe

në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një gjuhë vendëse. Ai vuri në dukje se tani është koha kur gjërat duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore, me punë dhe angazhim konkret, pa e politizuar dhe pa e rrezikuar askënd. Në këtë kontekst, ai theksoi se ka një avancim zyrtar të shqipes në RMV, por që gjithçka duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm për të ecur edhe më tej përpara.

Në fund të këtij takimi, nikoqirët i dhuruan edhe disa kopje të botimeve të ASHAK-së për bibliotekën e AZGJ-së.

2 nëntor 2020


Përfundoi trajnimi për planifikim strategjik për AZGJ-në

Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyeshëm mes AZGJ-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup, në selinë e AZGJ-së përfundoi trajnimi treditor onllajn për planifikim strategjik.

Trajnimi i realizuar ka për qëllim forcimin e burimeve njerëzore në AZGJ, zhvillimin e kapacitetit profesional dhe rritjen e efikasitetit në arritjen e qëllimeve dhe planeve të përcaktuara të punës, duke krijuar plan strategjik cilësor dhe gjithëpërfshirës të punës.

Në aspektin përmbajtësor, trajnimi përfshiu prezantime nga ekspertë të fushës së planifikimit strategjik, të shoqëruar me ushtrime praktike për pjesëmarrësit në trajnim. Gjatë trajnimit u shpjeguan konceptet kryesore të planifikimit strategjik; analiza organizative dhe metodologjia e planifikimit strategjik; zhvillimi institucional dhe ndryshimi organizativ; vizioni/misioni i organizatës; analiza e mjedisit; krijimi i instituciogramit; analiza SWOT; përcaktimi i qëllimeve strategjike; përmbajtja dhe formati i planit strategjik si dhe elemente në pjesën e planifikimit financiar dhe operacional.





Mbështetjen që e mundësoi Misioni i OSBE-së në Shkup për realizimin e trajnimit, ka rëndësi të madhe për AZGJ-në dhe në praktikë vërteton marrëdhëniet e shkëlqyera dhe bashkëpunimin e mirë ndërmjet të dy palëve, të cilat shpresojmë të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

4 nëntor 2020

AZGJ-ja dhe MALMED e përforcojnë bashkëpunimin

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, pati një takim pune me Lirim Shabanin, u.d. drejtor i Agjencisë së Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore (MALMED).

Kjo është vizita e dytë e drejtorit Sela në MALMED, ndërkaq takimi u shfrytëzua për të riafirmuar interesin për bashkëpunim ndërmjet AZGJ-së dhe MALMEDI-t, duke ofruar konsultime dhe ndihmë për çështjet gjuhësore, si dhe lekturimin e akteve zyrtare, formularëve dhe licencave nga fusha e punës së MALMED-it.



Njëkohësisht, në takim u diskutua rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e MALMED-it, dhe u diskutua interesi i qytetarëve si konsumatorë që udhëzimet e përdorimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore të shkruhen në gjuhët zyrtare.

Të dy palët u zotuan që të intensifikojnë bashkëpunimin dhe të vazhdojnë dialogun e ndërsjellë.

4 nëntor 2020

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, të gjithë fjalorët terminologjikë që i kishte në Institutin e Studimeve Politike dhe Ndërkombëtare (ISPN), ia dhuroi AZGJ-së, për nevojat e përkthyesve dhe të lektorëve.



5 nëntor 2020

Takim pune i drejtorit Sela në Ministrinë e Drejtësisë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Ministrinë e Drejtësisë ku pati një takim pune me ministrin Bojan Mariçiq.

Duke e falënderuar për takimin, drejtori Sela theksoi se ky takim synon të rishikojë situatën në lidhje me zbatimin e dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në nivelin institucional dhe në atë gjyqësor, si dhe një diskutim mbi zbatimin e praktikave më të mira për zgjidhjet ligjore të cilat kërkojnë burime të konsiderueshme materiale dhe njerëzore.

Drejtori Sela paraqiti një sërë botimesh të AZGJ-së dhe shprehu gatishmëri për bashkëpunim ndërinstitucional me Ministrinë e Drejtësisë, duke ofruar ndihmë ekspertësh në përkthimin dhe lekturimin e formularëve, veçanërisht certifikatave të marra nga qytetarët, botimi i të cilave është përgjegjësi e ministrisë, siç është vërtetimi për provimin e jurisprudencës, provimin për agjentët e përmbarimit, ndërmjetësit, provimin e noterisë etj.





Të dy palët riafirmuan angazhimin e tyre për të vazhduar dialogun dhe për të forcuar më tej bashkëpunimin ndërinstitucional.

10 nëntor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela realizoi takim pune në Agjencinë e Punësimit

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune me drejtorin e sapoemëruar të Agjencisë së Punësimit, Abdush Demiri. Në këtë takim ai ia uroi postin e drejtorit, duke theksuar faktin se për herë të parë në krye të këtij institucioni të rëndësishëm emërohet një kuadër shqiptar.

Me këtë rast, Demiri e informoi drejtorin Sela rreth gjendjes së kuadrit, nivelin e zbatimit të gjuhës shqipe në këtë agjenci, si dhe për sfidat që e presin në të ardhmen.





Drejtori Sela u zotua se AZGJ-ja do të ofrojë mbështetje dhe ndihmë profesionale rreth përkthimit dhe lekturimit të formularëve dhe akteve zyrtare, si dhe ndihmë këshillëdhënëse për zbatim sa më të drejtë të dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, me qëllim që qytetarët të kenë qasje sa më të lehtë në marrjen e shërbimeve nga ky institucion.

Të dy palët u zotuan për intensifikimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

13 nëntor 2020

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale vazhdojnë bashkëpunimin e tyre

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, vizitoi Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale, ku pati një takim pune me ministren Jagoda Shahpaska.

Gjatë këtij takimi, ata theksuan se kjo ministri paraqet një lidhje jashtëzakonisht të rëndësishme në sistemin institucional, që siguron spektër të gjerë të shërbimeve publike për qytetarët në fushën e mbrojtjes sociale dhe në atë të fëmijëve, të sigurimit pensional dhe invalidor, mundësi të barabarta,

marrëdhënie pune etj. Në këtë kontekst, ata vunë në dukje se është veçanërisht e rëndësishme të punohet në aspektin e zbatimit të plotë dhe të qëndrueshëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në interes të shfrytëzimit të së drejtës së qytetarëve për shërbimet publike të ministrisë në gjuhët zyrtare.





Drejtori Sela shprehu gatishmëri për të mbështetur ministrinë në fushën e përkthimit dhe të lekturës së formularëve, kërkesave, certifikatave, licencave që i përdorin qytetarët në procedurat për realizimin e të drejtave të tyre ligjore.

Ministrja Shahpaska theksoi se po ndërmerren aktivitete për përshtatjen e ueb faqes së ministrisë në të dy gjuhët zyrtare për të cilat ka përfunduar furnizimi publik. Gjithashtu, shtoi ajo, do të punohet në fushën e sigurimit të kuadrit profesional për përkthim dhe lekturë, për zhvillimin pa pengesë të procesit të përkthimit dhe lekturimit të akteve zyrtare të ministrisë në gjuhët zyrtare.

Kjo vizitë e drejtorit Sela është e dyta në këtë ministri gjatë vitit 2020 dhe paraqet konfirmim të përpjekjeve të dy institucioneve për të vazhduar avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në interes të qytetarëve.

15 nëntor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela – homazh te varri i Gjerasim Qiriazit

Në suaza të Ditëve të Alfabetit 2020, që u hapën në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, aktivitetet e tjera vazhduan në Strumicë me një vizitë te varri i atdhetarit dhe iluministit Gjerasim Qiriazi, ku u bënë homazhe nga shumë përfaqësues të jetës kulturore, shkencore, arsimore, shoqërore, politike, diplomatike etj.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësuesit e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, drejtori i saj Ylber Sela dhe përgjegjësi i Sektorit të përkthimit dhe lekturimit, Ahmet Selmani, të cilët vendosën lule mbi varrin e Gjerasim Qiriazit.





Me këtë rast, drejtori Ylber Sela para të pranishmëve foli për kontributin e kësaj figure të rëndësishme kombëtare.


19 nëntor 2020

Drejtori Sela për vizitë në Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, e vizitoi Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive (AKP), ku realizoi takim pune me drejtorin Boris Tunxhev.

Drejtori Sela theksoi se ky takim është në funksion të vështrimit të gjendjes në lidhje me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në AKP si një institucion mjaft i rëndësishëm, shërbimet e të cilit çdo ditë shfrytëzohen nga qytetarët dhe që gjeneron një vëllim të madh dokumentesh për persona fizikë dhe juridikë.





Gjatë vizitës, u konstatua se AKP-ja vonon me realizimin e detyrimeve ligjore dhe se, pavarësisht se është filluar me aktivitete të caktuara siç është përshtatja e përmbajtjes së ueb faqes së AKP-së në gjuhët zyrtare dhe ndryshimi i emërtimeve të tabelave, të akteve zyrtare si formularëve, fletëparaqitjeve, kërkesave, fletëpronësive etj., megjithatë, qytetarët përsëri nuk mund t'i marrin ato në gjuhët zyrtare, me çka atyre u pamundësohet e drejta që shërbimet publike t'i realizojnë në gjuhët zyrtare.

Drejtori Sela i dhuroi drejtorit Tunxhev disa botime të AZGJ-së dhe shprehu gatishmëri për bashkëpunim me AKP-në, duke ofruar ndihmë profesionale për përkthimin dhe lekturën e formularëve, fletëparaqitjeve, kërkesave, autorizimeve etj., dhënia e të cilave është kompetencë e AKP-së. Gjithashtu, drejtori Sela u shpreh se pret që të dinamizohet procesi i harmonizimit të AKP-së me detyrimet ligjore.

Të dyja palët u angazhuan për të bashkëpunuar në interes të qytetarëve dhe të kenë koordinim të rregullt rreth çështjeve lidhur me implementimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

20 nëntor 2020

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Institutin e Albanologjisë në Prishtinë

Në suaza të Ditëve të Alfabetit 2020, sot në Shkup Agjencia e Zbatimit të Gjuhës nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Dokumentin në fjalë e nënshkruan dy homologët e këtyre institucioneve, dr. Ylber Sela (AZGJ) dhe dr. Hysen Matoshi (IAP).

Pas këtij akti solemn, ata theksuan simbolikën që ka ky memorandum pikërisht në Ditët e Alfabetit, si dhe rëndësinë e veçantë të bashkëpunimit në fushën e gjuhës shqipe, shkëmbimeve të ndryshme shkencore, kulturore etj.







21 nëntor 2020

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela me rastin e Ditës së Alfabetit

Të dashur miq!

Të rralla janë ngjarjet historike të cilat, jo vetëm që nuk harrohen e nuk zbehen fare nga kujtesa jonë kolektive, por, sa më shumë që kalon koha, bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, më frymëzuese dhe më ndërgjegjësuese për të gjithë ne. Pa dyshim, këtu bën pjesë edhe Kongresi i Alfabetit, ose Kongresi i Manastirit, i cili sivjet i mbush 112 vjet, si një ngjarje që shënoi kthesë të madhe dhe vendimtare në historinë kulturore të shqiptarëve dhe që e hapi edhe rrugën e konsolidimit shtetëror më 1912.



Së pari, ky kongres është vetvetiu histori, për arsye se populli shqiptar për herë të parë arriti të formësohet në aspektin kulturor duke zgjedhur rrugën e duhur në udhëkryqin e ndërlikuar të historisë, thjesht duke u përcaktuar për modelin alfabetik që do ta përdorte, pra atë latin të cilin e përdorte gjithë Europa, ku gjeografikisht bëjnë pjesë edhe shqiptarët. Në këtë mënyrë ndodhi rikthimi i natyrshëm në gjirin e vet kulturor e qytetërues.

Së dyti, Kongresi i Alfabetit është vetvetiu një simbolikë e veçantë, për arsye se, që nga ajo ditë, kur mbizotëroi fryma e unitetit shqiptar, u bë udhërrëfyes edhe për shumë beteja të tjera të mëvonshme, duke shërbyer si shembull pozitiv se si mund të bëhen shumë gjëra të mëdha me anë të mirëkuptimit e bashkimit. Prandaj, edhe më tej vazhdon të mbetet simbolikë themelore e shqiptarëve, duke u bërë edhe referencë aktuale për arritjen e qëllimeve kulturore, arsimore, shkencore, politike e kombëtare.

Së treti, Kongresi i Manastirit është një testament kulturor e qytetërues i shqiptarëve, të cilin e lexojnë dhe e analizojnë të gjitha brezat duke reflektuar në mënyrë pozitive e racionale. Sigurisht, edhe ne kemi fatin e madh që të flasim e të japim ndihmesë në këtë aspekt, si dhe ta përcjellim frymën e tij tek ata që do të vijnë pas nesh.

Së katërti, Kongresi i Alfabetit na rikthen në kohë dhe në hapësirë, jo vetëm për ta përkujtuar në mënyrë nostalgjike si ngjarje, por edhe për t'u rikthyer fizikisht në qytetin e Manastirit si vatër e rëndësishme e Rilindjes sonë Kombëtare dhe për të dëshmuar kujdesin dhe mirënjohjen tonë ndaj tij, për t'i bërë sfidë harresës dhe shpërfilljes në këtë kohë marramendëse. Dhe si i tillë, Manastiri mbetet krenari kombëtare.

Natyrisht, të gjitha këto mua personalisht më bëjnë jashtëzakonisht krenar si shqiptar, por aq më tepër edhe si drejtor që kam fatin ta udhëheq Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës Shqipe, që çdo ditë e më tepër jep ndihmesën e vet në zbatimin zyrtar të kësaj gjuhe, e cila shkruhet pikërisht me ato shkronja që u zgjodhën si model në Kongresin e Alfabetit më 1908 në Manastir.

Uroj që kjo ngjarje të mbetet testament i përjetshëm kombëtar. Pa shkronja, nuk ka gjuhë. Pa gjuhë, nuk ka komb. Duhet ta kemi të qartë se vetëm me këto shkronja dhe me këtë gjuhë, ne do të quhemi shqiptarë në kuptimin thelbësor.

Ju falem nderit!

23 nëntor 2020

AZGJ-ja ia uron çmimin "22 Nëntori" Xhevat Lloshit

Me marrjen e Çmimit Shtetëror "22 Nëntori", të cilin e ndan Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e Ditës së Alfabetit, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së ia uron studiuesit dhe gjuhëtarit Xhevat Lloshi këtë mirënjohje të lartë për kontributin e tij shkencor në fushën e gjuhës shqipe, duke i uruar shëndet e mbarësi edhe në të ardhmen.





Xhevat Lloshi ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetës i fuqishëm i punës së institucionit tonë, duke mos e kursyer as mundin e as dijen e tij për ta ndihmuar në çdo situatë AZGJ-në, e cila po kujdeset me përpikëri për zbatimin zyrtar të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore të RMV-së.


25 nëntor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela u paraqit me kumtesë në Seminarin XIV Ndërkombëtar të Albanologjisë

Në Seminarin XIV Ndërkombëtar të Albanologjisë që u mbajt në Universitetin e Tetovës në temë "Sfidat e (mos)zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut dhe gabimet gjatë përdorimit të shqipes standarde", krahas pjesëmarrësve të shumtë, me kumtesë onllajn u paraqit edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela.

Në kumtesën e titulluar "Sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut", ai vuri në dukje rolin e rëndësishëm të AZGJ-së në aspektin e angazhimit, ndihmës dhe mbështetjes që ua jep institucioneve të ndryshme shtetërore për zbatimin e gjuhës shqipe, por gjithashtu edhe qytetarëve nëpërmjet botimit dhe shpërndarjes së doracakëve dhe fletushkave, ku jepen të dhëna konkrete për të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe.





Me këtë rast ai theksoi edhe sfidat dhe vështirësitë që shfaqen në zbatimin e gjuhëve zyrtare, duke u ndalur veçmas në ngecjen dhe moszbatimin e këtij ligji nga ana e institucioneve.

26 nëntor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela në takim pune në Agjencinë e Mërgatës të RMV-së

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij realizoi një takim pune në Agjencinë e Mërgatës të RMV-së, ku u prit nga drejtori i saj, Sllobodan Bliznakovski, dhe zëvendësdrejtori Izmit Nura.



Gjatë këtij takimi u diskutua për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion, ku u bënë disa sqarime lidhur me dilemat dhe paqartësitë që ekzistojnë për sa u përket emërtimeve dhe përkthimeve nga maqedonishtja në shqip.

Me këtë rast drejtori Ylber Sela ofroi mbështetje dhe ndihmë për vazhdimin e zbatimit praktik të gjuhës shqipe në këtë institucion.

26 nëntor 2020

Në AZGJ u promovua libri "Atlas dialektologjik i të folmeve shqipe në RMV" i Mustafa Ibrahimit

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës u promovua libri "Atlas dialektologjik i të folmeve shqipe në RMV" (I-II) i autorit Mustafa Ibrahimi. Në fillim pjesëmarrësit i përshëndeti drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela i cili, në mes të tjerash,

theksoi se Mustafa Ibrahimi ka qenë që nga fillimi bashkëpunëtor i AZGJ-së, duke treguar gjithmonë vullnet dhe gatishmëri për të ndihmuar në aktivitetet e saj. Prandaj, shtoi më tej ai, libri i sotëm paraqet një vazhdimësi, me çka na e paraqet si një ekskluzivitet që ne ta shohim nën prizmin e dritës shkencore.

Ndërkaq, për vlerat shkencore të librit në fjalë folën referuesit Ismet Osmani, shef i Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, Marjan Markoviq nga Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve, Nexhip Mërkuri, profesor universitar nga Vlora, të cilët i vunë në dukje disa aspekte shkencore që e karakterizojnë këtë vepër nga fusha e dialektologjisë.



Në fund disa fjalë mirënjohëse i tha edhe autori Mustafa Ibrahimi, i cili u falënderua për promovimin e organizuar nga AZGJ-ja.

1 dhjetor 2020

Takim pune i drejtorit Sela në Agjencinë e Aviacionit Civil

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, sot e vizitoi Agjencinë e Aviacionit Civil, ku pati një takim pune me drejtorin e saj, Tomislav Tuntev.

Drejtori Sela falënderoi homologun e tij për realizimin e këtij takimi dhe shprehu gatishmërinë për mbështetje ndaj Agjencisë së Aviacionit Civil, në pjesën e përkthimit dhe të lekturimit të akteve (certifikata, leje për pilot etj.) që i lëshon ky institucion, si dhe për ndihmë në pjesën e përkthimit të terminologjisë së specializuar të aviacionit, që rrjedh nga rregulloret dhe standardet ndërkombëtare të aviacionit.



Drejtori Tuntev e informoi se AAC-ja, si trup i pavarur rregullator me autorizime publike, punon sipas rregulloreve dhe standardeve ndërkombëtarisht të pranuara të ICAO, EUROCONTROL, JAA/EASA, ECAC dhe qëndron e hapur për bashkëpunim me AZGJ-në për çështje me interes të përbashkët.

Të dyja palët u zotuan për ta vazhduar dialogun edhe në të ardhmen.

2 dhjetor 2020

Takim i drejtorit Sela me kryetarin e ASHAM-it

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, sot e vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë (ASHAM), ku u takua me kryetarin e saj, Ljupço Kocarev si dhe me nënkryetarët, Gazanfer Bajram dhe Zhivko Popov.

Gjatë këtij takimi u diskutuan shumë çështje që janë me interes të përbashkët, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Sado që është e konstatuar se ASHAM-i ka vonesë në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, kryetari Kocarev theksoi se ajo që është detyrim ligjor duhet të respektohet.

Pas përfundimit të procesit të ndryshimit të Ligjit të ASHAM-it, i cili është në procedurë kuvendare dhe që përmban emërtimin e ri të akademisë, ajo do ta ndryshojë tabelën, memorandumet, vulat dhe faqen e internetit. Gjithashtu, do të ndryshojë edhe akti i sistematizimit të vendeve të punës dhe i statutit të ASHAM-it, shtoi më tej ai.



Drejtori Y. Sela theksoi se është në interesin e AZGJ-së bashkëpunimi me ASHAM-in, si institucioni më i lartë shkencor dhe artistik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zbatimi i vendimit ligjor për përdorimin e gjuhëve zyrtare në punën e ASHAM-it, nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit, në mënyrë që të krijohet një bazë për bashkëpunim në projekte të përbashkëta nga fusha e terminologjisë gjuhësore, shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave, si dhe pjesëmarrja e anëtarëve të ASHAM-it në aktivitetet që i organizon AZGJ-ja. Njëkohësisht, drejtori Sela i dorëzoi akademikut Kocarev një sërë botimesh të AZGJ-së.

Të dyja palët shprehën bindjen se takime të tilla janë të një natyre konstruktive dhe se ekziston një gatishmëri për të zhvilluar dialog të rregullt ndërinstitucional.

4 dhjetor 2020

AZGJ-ja merr pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare për Arsim Multikulturor



AZGJ-ja me përfaqësuesin e saj mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare për Arsimin Multikulturor, e cila u mbajt (onllajn) në Tetovë në periudhën 2-4 dhjetor 2020.

Konferenca u organizua nga Qendra e Bashkëpunimit Ballkanik - "LOJA" – Tetovë (QBB LOJA), në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e mbështetur nga Qendra Gjermane e Trajnimit dhe e Rrjetëzimit, KURVE Wustrow. Prezantimi i përfaqësuesit të AZGJ-së ishte në temën "Koncepti i multikulturalizmit në kohë krize" (The Concept of Multiculturalism in Times of Crisis).





AZGJ-ja edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me aktivitete, duke marrë pjesë në ngjarje që kanë të bëjnë me gjuhësinë, terminologjinë e gjuhës, multikulturalizmin, mirëkuptimin ndëretnik dhe bashkëjetesën, nëpërmjet mësimit të gjuhës, tolerancës, dialogut dhe bashkëpunimit.

4 dhjetor 2020

Pjesëmarrje e përfaqësuesve të AZGJ-së në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare

Në periudhën 2 – 4 dhjetor 2020, përfaqësuesit e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) morën pjesë me prezantimin e tyre në konferencën shkencore ndërkombëtare onllajn me temë "Gjuha dhe ndërgjegjësimi".

Konferenca u organizua nga Rating Academy, e cila vepron në suaza të Universitetit Çanakkale Onsekiz Mart në Republikën e Turqisë.







Pjesëmarrja në konferencë ishte një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer ide mbi çështjet gjuhësore dhe është pjesë e aktiviteteve për krijimin e rrjeteve ndërkombëtare dhe afirmimin e AZGJ-së.

9 dhjetor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela në vizitë tek Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë "Pavell Shatev"

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, sot e vizitoi Akademinë e Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë "Pavell Shatev" në Shkup, ku pati takim pune me drejtoreshën e saj, Natasha Gaber Damjanovska.

Ky takim është pjesë e një vargu takimesh që drejtori i AZGJ-së i realizon me udhëheqësit e institucioneve të sektorit publik në lidhje me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përfshirë këtu dhe punën e akademisë si institucion publik.
Gjatë këtij takimi u konstatua se akademia është vonuar në realizimin e detyrimeve të zbatimit të dispozitave ligjore, edhe pse aktivitete të caktuara, siç është ndryshimi i vulave zyrtare, tabelave, kanë filluar, si dhe mundësia për të marrë testin psikologjik, si pjesë e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve në trajnimin fillestar të akademisë në gjuhët zyrtare.



Drejtori Sela theksoi se duhet një angazhim më i madh në mënyrë që akademia të intensifikojë procesin e harmonizimit të detyrimeve ligjore, dhe veçanërisht është e rëndësishme që ta mundësojë përdorimin e plotë të gjuhëve zyrtare në punën e saj, si dhe mundësinë që kandidatët t'i mbajnë provimet e akademisë në gjuhët zyrtare.

Drejtoresha Gaber Damjanovska e informoi bashkëbiseduesin e saj se aktualisht po zhvillohet procesi i përzgjedhjes për pranimin e gjeneratës së tetë të kandidatëve në trajnimin fillestar të akademisë, por për shkak të kufizimeve buxhetore, teknike dhe të personelit, provimet që janë pjesë integrale e procesit të përzgjedhjes nuk do të zhvillohet në gjuhët zyrtare, por do të bëhen përpjekje që nga viti i ardhshëm të përmirësohet situata. Në këtë kontekst, drejtori Sela theksoi se AZGJ-ja është e gatshme për bashkëpunim dhe mund të ndihmojë në këtë proces me anë të ndihmës profesionale në pjesën e përkthimit dhe të lekturës së akteve të akademisë, si dhe trajnimin e stafit në pjesën e përkthimit dhe përdorimit të terminologjisë së gjuhëve zyrtare.

Të dyja palët u zotuan të mbajnë komunikim dhe bashkëpunim të rregullt për realizimin sa më të lehtë dhe më efikas të të drejtave të qytetarëve në gjuhët zyrtare.

10 dhjetor 2020

Drejtori Sela mori pjesë në panel-diskutimin me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut

Me ftesë të Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, mori pjesë në panel-diskutimin me rastin e shënimit të 10 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të

Njeriut, me temë “Të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve – gjendje, tendenca dhe sfida”.







Në fjalimin e tij, drejtori Sela theksoi rëndësinë e shënimit të kësaj date simbolike, ndërkaq foli edhe për gjendjen lidhur me realizmin e të drejtës së përdorimit të gjuhës amtare, si një e drejtë elementare dhe për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në fund të panel-diskutimit, drejtori Sela iu përgjigj pyetjeve të të pranishmëve.

11 dhjetor 2020

Misioni i OSBE-së në Shkup i dhuroi disa botime AZGJ-së



Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet AZGJ-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup, sot u bë dorëzimi dhe pranimi i disa botimeve për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së, të dhuruara nga ana e këtij misioni.

Me këtë rast, drejtori i AZGJ-së Ylber Sela, shprehu falënderim për botimet e dhuruara, me shpresë se bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Shkup do të vazhdojë të zhvillohet edhe në të ardhmen.

15 dhjetor 2020

Drejtori organizativ i Klinikës së Radioterapisë dhe Onkologjisë e vizitoi AZGJ-në

Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës sot e vizitoi drejtori i Klinikës Universitare të Radioterapisë dhe të Onkologjisë, Nehat Nuhiu i shoqëruar nga mjeku onkolog Ilir Ismaili, të cilët i priti drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela.



Gjatë këtij takimi të dy homologët biseduan lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore. Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela i dha mbështetje të plotë për sa i përket zbatimit të gjuhës shqipe në këtë klinikë, duke i premtuar dhe ndihmë nga shërbimet e AZGJ-së në aspektin e përkthimit dhe të lekturimit të dokumenteve dhe akteve zyrtare.


Drejtori Nehat Nuhiu u falënderua për këtë mbështetje dhe ndihmë, duke u zotuar se do të fillojë ta zbatojë gjuhën shqipe në klinikë sipas detyrimeve ligjore.

21 dhjetor 2020

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela në takim me ministren Milla Carovska

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune me ministren e Arsimit dhe të Shkencës të RMV-së, Milla Carovska. Me këtë rast drejtori Y. Sela theksoi se qëllimi i këtij takimi është që së bashku të bëjmë diçka në aspektin e ndërtimit të shoqërisë sonë multietnike. Pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, shtoi ai në vazhdim, në RMV është krijuar një realitet tjetër. Në sistemin arsimor gjuha shqipe duhet të bëhet e detyrueshme për nxënësit maqedonas dhe gjuha maqedonase për nxënësit shqiptarë. Duhet të krijohet një vetëdije dhe disponim i ri. Por kjo varet shumë nga njeriu i parë që e drejton një institucion. Si shembull i mirë duhet të na shërbejë përvoja e Bolzanos, një qytet shumëgjuhësh në Itali, ku funksionojnë në mënyrë të shkëlqyer tri gjuhë zyrtare, si dhe në disa vende të tjera të Bashkimit Europian.





Për sa u përket të dy institucioneve, vuri në dukje ai, ne mund të bëjmë shumë gjëra të përbashkëta, bie fjala shënimin e Ditës Europiane të Gjuhëve në muajin shtator, ku bashkë me ne mund të përfshihet edhe Këshilli i Europës. Po ashtu, me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës mund të organizojmë debate për librat shkollorë, ku ne gjithsesi mund ta japim kontributin tonë. Drejtori Sela i propozoi ministres Carovska që në vitin e ardhshëm shkollor akademik, të ndahen bursa për studentët e katedrave të përkthimit dhe të interpretimit për universitetet tona, të cilët pastaj do të përfshiheshin në institucionet shtetërore për nevojat e tyre në fushën e përkthimit.

Ne japim mbështetje të plotë në aspektin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, theksoi në fund Ylber Sela, veçmas për sa u përket formularëve, dokumenteve dhe akteve zyrtare të ministrisë, për të cilat AZGJ-ja ka detyrë ligjore që t'i lekturojë ato.
Për të gjitha këto ide dhe propozime, ministrja Milla Carovska shprehu gatishmëri të plotë për t'i realizuar bashkërisht, edhe shënimin e Ditës Europiane të Gjuhëve, edhe ndarjen e bursave për studentët, edhe shumë gjëra të tjera etj.
Takimi u mbyll duke u zotuar që këto gjëra të konkretizohen dhe të realizohen.

22 dhjetor 2020

Takim pune i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela te Këshilli Inspektues

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, sot realizoi vizitë pune në Këshillin Inspektues, ku u takua me kryetaren e tij, Magdalena Filipovska – Grashkoska, dhe sekretaren e përgjithshme Daniela Rendevska. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan se Këshilli Inspektues është një institucion kyç në sistemin e inspektimit dhe një takim i këtillë është më se i dobishëm, për arsye se paraqet një mundësi për të shkëmbyer mendime në lidhje me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e këtij këshilli.

Përkundër vonesës në realizimin e aspekteve të caktuara të ligjit në funksionimin e përditshëm të Këshillin Inspektues, në këtë takim u shqyrtuan dilema të caktuara në lidhje me zbatimin praktik të aktvendimit ligjor. Drejtori Y. Sela ofroi mbështetje të plotë në fushën e ndihmës profesionale për përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve zyrtare dhe të akteve.




Gjithashtu, u dakorduan që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, të fillojë një procedurë për përshtatjen e akteve nënligjore që e përshkruajnë formën dhe përmbajtjen e akteve të inspektimit, për t'i siguruar versionet gjuhësore të akteve në të dy gjuhët zyrtare.


Të dy palët u zotuan ta avancojnë më tej bashkëpunimin në interes të sigurimit të plotë dhe të respektimit të qëndrueshëm të detyrimeve ligjore.

23 dhjetor 2020

AZGJ-ja dhe Ministria e Vetëqeverisjes Lokale e përforcojnë bashkëpunimin

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, sot vizitoi Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, ku realizoi takim pune me ministrin e saj, Goran Milevski.

Në takim u diskutua për çështjet që u vlerësuan si prioritet në pjesën e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në realizimin operativ të kompetencave të kësaj ministrie.

Drejtori Ylber Sela theksoi se kjo ministri është një subjekt i rëndësishëm institucional që kujdeset për funksionimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në interes të ofrimit të shërbimeve publike cilësore për qytetarët dhe për realizimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurat administrative.

Bashkëbiseduesit konstatuan se ministria po ballafaqohet me kapacitet të kufizuar të kuadrit për përkthim dhe lekturë, ku drejtori Sela u ofroi ndihmë për tejkalimin e kësaj situate nëpërmjet shërbimeve profesionale nga ana e AZGJ-së në pjesën e përkthimit dhe të lekturimit të akteve zyrtare në kompetencë të ministrisë.

Gjithashtu, u shkëmbyen edhe ide për bashkëpunim në projektet e ardhshme në pjesën e përgatitjes së publikimeve për përdorimin e gjuhëve zyrtare në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe iniciativa të tjera për të cilat do të diskutohen modalitetet për realizimin e tyre.

6.1. Buxheti, llogaria përfundimtare dhe financimi

AZGJ-ja si organ i pavarur shtetëror është shfrytëzues buxhetor.

Në vitin 2020 buxheti bazë i miratuar i AZGJ-së ishte 60.000.000,00 denarë. Me të dy ribalancat e buxhetit për vitin 2020, buxheti bazë i AZGJ-së u zvogëlua në vlerën totale prej 34.291.000,00 denarë.

Nga vlera e përgjithshme e mjeteve të miratuara buxhetore pas të dy ribalancave, 33,94% ishin të përcaktuara për rroga dhe kontribute, 36,02% për mallra e shërbime dhe 30,04 për harxhime kapitale.

Struktura e buxhetit të AZGJ-së për vitin 2020

Zëri	Përshkrimi	BUXHETI PËR VITIN 2020 (në kundërvlerë denari)					RIBALANCA E BUXHETIT PËR VITIN 2020 (janë të përfshirë të dy ribalancat)	
		Buxheti (630)	Shpenzime nga të ardhurat prej organeve (631)	Shpenzime nga aktivitete vetëfinancuese (787/788)	Shpenzime nga donacione (785)	Gjithsej shpenzime	Gjithsej shpenzime	Përqindja e realizimit (%) (përfshirë të dy ribalancat)
40	Rroga dhe kontribute	12.500.000,00	/	/	/	/	11.638.000,00	33,94%
401	Rrogat bazë	9.125.000,00	/	/	/	/	8.379.000,00	89,53%
402	Kontribute të sigurimit social	3.375.000,00	/	/	/	/	3.259.000,00	89,43%

42	Mallra dhe shërbime	27.900.000,00	/	/	/	/	12.353.000,00	36,02%
420	Shpenzime ditore dhe rrugore	100.000,00	/	/	/	/	400.000,00	99,93%
421	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	1.500.000,00	/	/	/	/	1.620.000,00	88,19%
423	Materiale dhe inventar i imët	1.200.000,00	/	/	/	/	720.000,00	82,63%
424	Riparime dhe mirëmbajtje e vazhdueshme	1.100.000,00	/	/	/	/	600.000,00	97,02%
425	Shërbime kontraktuese	22.000.000,00	/	/	/	/	7.563.000,00	99,93%
426	Shpenzime të tjera të vazhdueshme	2.000.000,00	/	/	/	/	1.450.000,00	93,50%
48	Shpenzime kapitale	19.600.000,00	/	/	/	/	10.300.000,00	30,04%
480	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	6.000.000,00	/	/	/	/	2.590.000,00	99,92%
481	Objekte ndërtimi	1.000.000,00	/	/	/	/	2.000.000,00	

								93,77%
483	Blerja e mobiljeve	1.800.000,00	/	/	/	/	0,00	0,00%
485	Investime dhe mjete jofinancuese	10.000.000,00	/	/	/	/	5.710.000,00	99,92%
486	Blerja e veturave	800.000,00	/	/	/	/	0,00	99,90%

6.2. Furnizime publike

1. Numri i vendimeve të marra për furnizime publike: 11

2. Numri i shpalljeve publike për furnizime publike SEFP: 11

3. Numri procedurave të filluara me bisedime pa shpallje paraprake: 0

4. Numri i vendimeve të miratuara për zgjedhjen e ofertës më të volitshme: 15

5. Numri i procedurave të anuluara: 2

6. Vlera e kontratave të lidhura për furnizime publike: 14.718.364,00 denarë pa TVSH, respektivisht 17.367.670,00 denarë me TVSH.

Vendime të miratuara për furnizime publike	Shpallje të hapura në SEFP	Procedura të filluara me bisedime pa shpallje paraprake	Vendime të miratuara për zgjedhjen e ofertës më të volitshme	Vendime të miratuara për procedura të anuluara	Kontrata të lidhura për furnizime publike
11	11	0	15	2	12

REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

- Të gjithë organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, t'i zbatojnë detyrimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Të njëjtat detyrime duhet të vlejnë edhe për ndërmarrjet private, qofshin ato të huaja apo të vendit.
- Realizimi i detyrimeve, para së gjithash, nënkuptohet ndërtimi i kapaciteteve të kuadrit dhe ato teknike në suazat e organeve (angazhimi i përkthyesve dhe lektorëve të kualifikuar, sigurimin e softuerit të përkthimit etj.) Të gjithë organet në aktin e tyre të sistematizimit dhe organizimit të brendshëm të vendeve të punës të, parashohë forma organizative/vende të punës për përkthyes dhe interpretues në dhe nga gjuha shqipe.
- Të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemit me mungesën e lektorëve të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston institucion kompetent për realizimin e provimit për lektor të gjuhës shqipe dhe lëshimin e licencave për lektorë të gjuhës shqipe.
- Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë, të krijojë politika nëpërmjet të cilave do të rritet atraktiviteti për regjistrim në katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe (drejtimi përkthim dhe interpretim) në institucionet publike të arsimit të lartë (për shembull, nëpërmjet rritjes së kuotave të regjistrimit, ndarjen e bursave të studimit dhe suksesit të arritur, punësimi i garantuar/stazhionimi me prioritet për punësim në sektorin publik etj.)
- Orvatjet e autoriteteve të drejtësisë të drejtohen nga ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve për përdorimin efektiv dhe efikas të gjuhëve në procedurat gjyqësore, administrative, procedurat e përmbarimit, procedurat e ekzekutimit të sanksioneve, procedurat hetimore dhe parahetimore, si edhe procedura të tjera para gjyqeve, prokuroritë publike, si edhe të gjithë organet e tjera të gjyqësisë, trupa dhe institucione.

- Ndërtimi i konceptit të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët medoemos duhet të ketë reflektim në arsim, duke filluar nga ai fillor, nëpërmjet reformave të mësimit të gjuhës së bashkëqytetarit tënd, si mjet kryesor komunikimi, bashkëjetesë dhe kuptim i ndërsjellë.
- Të sigurohet respektim i tërësishëm i detyrimit ligjor të publikimeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" të ligjeve, akteve nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet e pushtetit shtetëror, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj. Ende nuk kemi respektim të tërësishëm të ligjit nga kjo palë.
- Të gjithë institucionet kompetente t'i harmonizojnë aktet e veta të brendshme me dispozitat gjuhësore të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.
- Institucionet që punojnë nëpërmjet sportelit/pultit, të sigurojnë që personat që punojnë në sportel/pult të kenë njohuri të të dy gjuhëve zyrtare. Vetëm kështu mund të arrihet dhe respektohet dygjuhësia institucionale.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i intensifikojë aktivitetet e ngritjes së vetëdijes publike, për zbatimin e vendimit ligjor të gjuhëve, si rregull pozitiv ligjor dhe t'i drejtojë aktivitetet e veta nga forcimi i konceptit qytetar të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët.

AZGJ-ja do të vazhdojë edhe më tutje me punën e saj të pandërprerë të jetë një faktor aktiv institucional në aspektin e zbatimit efikas dhe efektiv të kompetencave të veta në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, njëherësh, një vazhdimësi, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

rr. “Filipi i Dytë i Maqedonisë” nr. 16, kati i 3-të

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Ky raport është publikuar në mars të vitit 2021.

I qasshëm është në maqedonisht, në shqip dhe në anglisht.